



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 137

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 6 gusht 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 79/2024, datë 26.7.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Gjeorgjisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar..... 16585
Dekret i Presidentit nr. 279, datë 31.7.2024	Për shpallje ligji..... 16598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 1.8.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar..... 16598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar..... 16610
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 1.8.2024	Për një shtesë në vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”, të ndryshuar..... 16611
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në shërbimin spitalor”, të ndryshuar..... 16612
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 1.8.2024	Për dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 vje, status special” subjektit “E & A Investment Vlorë” sh.p.k..... 16612
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar..... 16613

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 1.8.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 692, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre’”, të ndryshuar.....	16613
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, të ndryshuar.....	16614
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 302, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore”.....	16615
Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 524, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 285, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit”.....	16616
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 284, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave”.....	16617
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 526, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, të ndryshuar.....	16617
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 1.8.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 63, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2024”.....	16618
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 1.8.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 62, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2024, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil”.....	16619
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 1.8.2024	Për lirin nga detyra të një anëtarit të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues.....	16619
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 1.8.2024	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2024, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për sezonin turistik 2024.....	16619
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 13, datë 10.7.2024	Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar.....	16620
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 124, datë 26.7.2024	Për caktimin e nënprefektit të Sarandës, z. Kristo Kiço, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të prefektit të qarkut Vlorë.....	16631
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 402, datë 31.7.2024	Për delegim kompetence.....	16631

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 580, datë 29.7.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Brazilit.....	16632
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 169, datë 31.7.2024	Për delegim të përkohshëm kompetencash.....	16632
Urdhër i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 150, datë 2.8.2024	Për delegim kompetence.....	16633
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 549 (2983), datë 25.6.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ndrekë Simoni.....	16633



LIGJ
Nr. 79/2024

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
GJEORGJISË PËR SHKËMBIMIN DHE
MBROJTJEN E NDËRSJELLË
TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Gjeorgjisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekreten nr.279, datë 31.7.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË GJEORGJISË MBI
SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN
RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Gjeorgjisë (më poshtë quhen “Palët”),

duke rënë dakord të zhvillojnë bisedime mbi çështjet në lidhje me politikën dhe sigurinë dhe të zgjerojnë dhe fuqizojnë bashkëpunimin e tyre politik, ushtarak dhe ekonomik;

duke marrë parasysh ndryshimet në situatën politike në botë dhe duke njohur rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për stabilizimin e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit të ndërsjellë;

duke qenë të ndërgjegjshëm që bashkëpunimi i efektshëm mund të kërkojë shkëmbimin e Informacionit të Klasifikuar ndërmjet Palëve;

me dëshirën për të krijuar një komplet rregullash që rregullojnë mbrojtjen e reciproke të Informacionit të Klasifikuar të zbatueshëm për çdo marrëveshje ose dokument që përmban ose ka të bëjë me Informacionin e Klasifikuar dhe Kontratat e Klasifikuara, që do të lidhen ndërmjet Palëve dhe/ose Kontraktorëve dhe Nënkontraktorëve të Palëve në të ardhmen ose që janë lidhur ose shkëmbyer deri në hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;

duke respektuar sovranitetin, barazinë, integritetin territorial, sigurinë dhe interesat e shteteve të tyre,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është sigurimi i mbrojtjes së Informacionit të Klasifikuar që përmban sekret shtetëror në pajtim me legjislacionin në fuqi të shteteve Palë dhe që shkëmbehet ose krijohet në procesin e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

2. Kjo Marrëveshje është e zbatueshme për çdo marrëveshje ose dokument që përmban ose përfshin Informacion të Klasifikuar dhe Kontrata të Klasifikuara, që do të lidhen apo shkëmbehen ndërmjet Palëve dhe/ose Kontraktorëve dhe Nënkontraktorëve të Palëve në të ardhmen ose që janë lidhur ose shkëmbyer deri në hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje

1. **“Informacion i Klasifikuar”** është çdo informacion verbal ose me shkrim, pavarësisht nga tipi/mjetet e mjetit të regjistrimit dhe çdo material



ose dokument që ka të bëjë me informacione që përmbajnë sekrete shtetërore në pajtim me legjislacionin në fuqi të shteteve Palë;

2. **“Kontratë e Klasifikuar”** është një kontratë (nënkontratë) ndërmjet një Pale dhe një Kontraktori ose një Kontraktori dhe një Nënkontraktori, e cila ka të bëjë me informacione që përmbajnë sekrete shtetërore ose mbi bazën e së cilës krijohet, riprodhohet ose ruhet ky informacion;

3. **“Kontraktor/Nënkontraktor”** është një individ ose një person juridik që ka zotësinë juridike për të lidhur kontrata (nënkontrata) dhe/ose një palë në një Kontratë të Klasifikuar, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;

4. **“Certifikatë Sigurimi Personeli”** është përcaktimi nga Autoriteti Kompetent i Sigurimit që një individ është i përshtatshëm për të pasur akses në Informacionin e Klasifikuar, në pajtim me legjislacionin në fuqi të shteteve Palë;

5. **“Certifikatë Sigurimi Industrial”** është përcaktimi nga Autoriteti Kompetent i Sigurimit, nga këndvështrimi i sigurisë, që një strukturë ka aftësinë fizike dhe organizative për të përdorur dhe administruar Informacionin e Klasifikuar, në pajtim me legjislacionin në fuqi të shteteve palë;

6. **“Nevojë për njohje”** është parimi, sipas të cilit, akses në Informacionin e Klasifikuar mund t'i jepet vetëm një individ të verifikuar paraprakisht se ka nevojë për njohje lidhur me kryerjen e detyrave të tij/saj zyrtare, brenda kuadrit të të cilit informacioni i është dhënë Palës Pritëse;

7. **“Palë e tretë”** është një shtet ose organizatë ndërkombëtare, që nuk është palë në këtë Marrëveshje;

8. **“Palë e Origjinës”** është Pala e cila i jep Informacion të Klasifikuar Palës Pritëse;

9. **“Pala Pritëse”** është Pala e cila merr Informacionin e Klasifikuar nga Pala e Origjinës;

10. **“Vizitorë”** janë përfaqësuesit zyrtarë të një Pale, të cilët kërkojnë të vizitojnë vendet dhe mjediset e Palës tjetër të angazhuar në aktivitete në lidhje me Informacionin e Klasifikuar.

Neni 3

Autoritetet Kompetente të Sigurisë

1. Autoritetet Kompetente të Sigurisë, përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, janë:

a) Për Republikën e Shqipërisë – Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurimit Kombëtar);

b) Për Gjeorgjinë – Shërbimi Shtetëror i Sigurisë i Gjeorgjisë.

2. Të dyja Autoritetet Kompetente të Sigurimit, secili brenda juridiksionit të shtetit të vet, siguron mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar të transmetuar ose të gjeneruar, në vijim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Me qëllim që të arrihen dhe të ruhen standarde të krahasueshme sigurie, Autoritetet Kompetente të Sigurimit, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikën e tyre të sigurimit për mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

4. Palët njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për çdo ndryshim në lidhje me Autoritetet e tyre Kompetente të Sigurimit.

Neni 4

Barasvlershmëria e niveleve të klasifikimit të sigurisë

1. Informacionit të Klasifikuar i caktohet një prej niveleve të barasvlershme të mëposhtme të klasifikimit të sigurisë:

Për Republikën e Shqipërisë:	Për Gjeorgjinë:	Termi i barasvlershëm në anglisht:
TEPËR SEKRET	განსაკუთრებული მნიშვნელობის	TOP SECRET
SEKRET	სრულიად საიდუმლო	SECRET
KONFIDENCIAL	საიდუმლო	CONFIDENTIAL
I KUFIZUAR	შეზღუდული სარგებლობისთვის	RESTRICTED



2. Afati i klasifikimit të Informacionit të Klasifikuar të shkëmbyer përcaktohet në pajtim me legjislacionin në fuqi të shtetit Palë të Origjinës.

3. Pala pritëse nuk e deklasifikon Informacionin e Klasifikuar dhe as e zhvlerëson atë, pa lejen paraprake me shkrim të Palës së Origjinës.

Neni 5

Mbrojtja e Informacionit të Klasifikuar

1. Aksesimi në Informacionin e Klasifikuar jepet vetëm për ata individë që kanë nevojë për njohje dhe të cilëve u është dhënë Certifikata e Sigurimit të Personelit, ose kanë autorizim për akses në Informacionin e Klasifikuar, në pajtim me legjislacionin në fuqi të shtetit Palë përkatës.

2. Pala Marrëse merr përgjegjësinë për të mos e transmetuar Informacionin e Klasifikuar sipas kësaj Marrëveshjeje te një palë e tretë, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës së Origjinës.

3. Pala Marrëse i cakton Informacionit të Klasifikuar një nivel mbrojtjeje të barasvlershëm me atë të caktuar nga Pala e Origjinës në pajtim me barasvlershmërinë e dhënë në nenin 4.

4. Pala Marrëse nuk e përdor Informacionin e Klasifikuar për ndonjë qëllim tjetër nga ai për të cilin është dhënë.

5. Pala Marrëse, në pajtim me legjislacionin në fuqi në shtetin e saj, mbron të drejta të tilla, si patentat, të drejtat e autorit, si dhe sekretet profesionale dhe tregtare që gjenden në Informacionin e Klasifikuar.

Neni 6

Verifikimet e Sigurisë

1. Vendimet në lidhje me dhënien e Certifikatës së Sigurimit të Personelit dhe Certifikatës së Sigurimit Industrial duhet të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi të shtetit të Palës përkatëse dhe i bazuar në rezultatet e procedurave të vetëgjut.

2. Palët njohin Certifikatën e Sigurimit të Personelit dhe Certifikatën e Sigurimit Industrial të lëshuara në pajtim me legjislacionin në fuqi të shtetit të Palës tjetër.

Neni 7

Vizitat

1. Vizitat që kërkojnë akses në Informacionin e Klasifikuar, i nënshtrohen pëlqimit paraprak të

Autoritetit Kompetent të Sigurimit të Palës pritëse. Autoriteti Kompetent i Sigurimit i një Pale, të paktën tri javë para vizitës së planifikuar, duhet të njoftojë Autoritetin Kompetent të Sigurimit të Palës tjetër në lidhje me vizitën.

2. Kërkesa e vizitës përmban informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e pasaportës dhe/ose letërnjoftimit;

b) kombësinë/shtetësinë e vizitorit;

c) titullin e pozicionit të vizitorit dhe emrin e organizatës së përfaqësuar;

d) Certifikatën e Sigurimit të Personelit për vizitorin;

e) qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar të vizitës;

f) emrat e organizatave dhe vendeve që kërkohen të vizitohen;

g) të dhëna të tjera, nëse bihet dakord me Autoritetet Kompetente të Sigurimit.

3. Autoritetet Kompetente të Sigurimit të Palëve miratojnë listën e vizitorëve, të cilët mund të kryejnë sërish vizita brenda dymbëdhjetë muajve për qëllimin e zbatimit të Kontratës së Klasifikuar. Termat e vizitave specifike rregullohen drejtpërdrejt nga Autoritetet Kompetente të Sigurimit.

4. Secila Palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve në pajtim me legjislacionin në fuqi në shtetin e Palës përkatëse.

Neni 8

Transmetimi i Informacionit të Klasifikuar

1. Informacioni i Klasifikuar duhet të transmetohet parimisht nëpërmjet kanaleve diplomatike ose nëpërmjet kanaleve të rena dakord paraprakisht nga Autoritetet Kompetente të Sigurimit.

2. Pala Marrëse konfirmon marrjen e Informacionit të Klasifikuar me shkrim.

3. Palët mund të transmetojnë Informacion të Klasifikuar me mjete elektronike në pajtim me procedurat e sigurisë të rena reciprokisht dakord nga Autoritetet Kompetente të Sigurimit.

4. Dorëzimi i materialeve voluminoze të Informacionit të Klasifikuar miratohet me shkrim, nga Autoritetet Kompetente të Sigurimit rast pas rasti.



Neni 9

Përkthimi dhe riprodhimi i Informacionit të Klasifikuar

1. Përkthimi dhe riprodhimi i Informacionit të Klasifikuar lejohet vetëm sipas parimit të nevojës për njohje. Origjinali dhe përkthimi/riprodhimi i Informacionit të Klasifikuar mbrohen në mënyrë të njëjtë. Numri i përkthimeve/riprodhimeve mund të kufizohet ose përjashtohet nga Pala e Origjinës.

2. Përkthimi/riprodhimi i Informacionit të Klasifikuar zhvillohet vetëm nga individët e certifikuar përshtatshmërisht.

3. Informacioni i Klasifikuar i shënuar si ТЕРЕК СЕКРЕТ/განსაკუთრებული მნიშვნელობის/TOP SECRET nuk riprodhohet nga Pala Marrëse dhe përkthehet vetëm pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga Autoriteti Kompetent i Sigurimit të Palës së Origjinës.

Neni 10

Asgjësimi dhe kthimi i Informacionit të Klasifikuar

1. Informacioni i Klasifikuar asgjësohet, nëse:

a) nuk mund të mbrohet, në pajtim me këtë Marrëveshje, gjatë një situatë krize;

b) Pala e Origjinës kërkon asgjësimin.

2. Informacioni i Klasifikuar asgjësohet deri në atë masë sa të parandalohet rindërtimi i pjesshëm ose i plotë i tij. Asgjësimi kryhet në pajtim me legjislacionin në fuqi në shtetet Palë.

3. Pala e Origjinës njoftohet mbi asgjësimin sa më shpejt të jetë e mundur nëpërmjet kanaleve të rëna reciprokisht dakord nga Autoritetet Kompetente të Sigurisë.

4. Me kërkesë, Informacioni i Klasifikuar i kthehet Palës së Origjinës.

Neni 11

Humbja ose kompromentimi

1. Pala Marrëse njofton menjëherë Palën e Origjinës për të gjitha humbjet ose kompromentimet, si dhe për të gjitha humbjet ose kompromentimet e mundshme të Informacionit të Klasifikuar dhe fillon një hetim për të përcaktuar rrethanat në lidhje me këtë.

2. Pala Marrëse i paraqet rezultatet e hetimit dhe informacionin mbi masat e marra për të parandaluar

rindodhjen e këtyre ngjarjeve Palës së Origjinës. Pala Marrëse mund të autorizojë Palën e Origjinës të marrë pjesë në një hetim.

Neni 12

Kontratat e Klasifikuara

1. Pala që dëshiron të lidhë një Kontratë të Klasifikuar me një Kontraktor/Nënkontraktor në shtetin e Palës tjetër, ose që dëshiron të autorizojë një prej Kontraktorëve/ Nënkontraktorëve të lidhë një Kontratë të Klasifikuar në shtetin e Palës tjetër për një projekt të klasifikuar, kërkon verifikim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kompetent i Sigurimit të Palës tjetër që Kontraktori/ Nënkontraktori i propozuar i mundshëm ka Certifikatë Sigurimi të përshtatshme.

2. Përgjegjësia e Kontraktorit/ Nënkontraktorit për të mbrojtur Informacionin e Klasifikuar, përfshin të paktën detyrimin e tij për të:

a) përhapur Informacionin e Klasifikuar vetëm atyre individëve që u është dhënë Certifikatë Sigurimi Personeli e përshtatshme dhe që kanë nevojë për njohje;

b) transmetuar Informacionin e Klasifikuar me mjetet sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;

c) shtjellon procedurat dhe mekanizmat për të informuar Autoritetin Kompetent të Sigurimit mbi ndryshimet që mund të lindin në lidhje me Informacionin e Klasifikuar, për shkak të ndryshimit të nivelit të klasifikimit ose për shkak se mbrojtja e Informacionit të Klasifikuar nuk është më e nevojshme;

d) përcaktuar procedurat për vizitat e personelit të një Pale tek Pala tjetër;

e) njoftojë Autoritetin Kompetent të Sigurimit mbi çdo akses të paautorizuar, faktik, të tentuar ose të dyshuar, në Informacionin e Klasifikuar;

f) përdorur Informacionin e Klasifikuar të marrë vetëm për qëllimet në lidhje me objektin e Kontratës së Klasifikuar;

g) respektuar procedurat e vendosura nga legjislacioni përkatës në fuqi në shtetet e Palë për asgjësimin e Informacionit të Klasifikuar.

3. Një njoftim për Kontratë të Klasifikuar i paraqitet paraprakisht Autoritetit Kompetent të Sigurimit të Palës ku kryhet puna.

4. Një kopje e seksionit mbi sigurinë në çdo Kontratë të Klasifikuar i paraqitet Autoritetit Kompetent të Sigurimit të Palës ku kryhet puna.



Autoriteti Kompetent i Sigurimit është përgjegjës për përcaktimin dhe administrimin e masave të nevojshme, në lidhje me zbatimin e Kontratës së Klasifikuar.

Neni 13
Shpenzimet

Secila Palë mbulon shpenzimet e veta të bëra gjatë zbatimit të masave të sigurisë të kësaj marrëveshjeje, përveç kur Palët bien dakord ndryshe rast pas rasti.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet ndërmjet Autoriteteve Kompetente të Sigurimit të Palëve nëpërmjet konsultimeve ose, në rast se një zgjidhje e tillë është e pamundur të arrihet, ndërmjet përfaqësuesve të autorizuar të Palëve nëpërmjet bisedimeve, pa iu referuar asnjë gjykatë kombëtare ose ndërkombëtare apo pale të tretë.

Neni 15
Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar kohe dhe hyn në fuqi pas marrjes së

njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike nga Palët, që konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2. Secila Palë mund të denoncojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet një njoftimi me shkrim mbi prishjen e marrëveshjes, komunikuar Palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Zbatimi i Marrëveshjes pushon 6 (gjashtë) muaj pas marrjes së njoftimit. Pavarësisht denoncimit së kësaj Marrëveshjeje, i gjithë Informacioni i Klasifikuar i transmetuar në pajtim me këtë Marrëveshje vazhdon të mbrohet ose asgjësohet në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

3. Kjo Marrëveshje ndryshohet dhe plotësohet me marrëveshje të reciproke të Palëve. Këto ndryshime ose shtesa që janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje, përfundohen si një dokument i veçantë. Këto hyjnë në fuqi në të njëjtën mënyrë si dhe kjo Marrëveshje.

Bërë në Tbilisi, më 18 shtator 2018, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën georgjiane, shqipe dhe angleze. Të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E GJEORGJISË

A G R E E M E N T

B E T W E E N

THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

A N D

THE GOVERNMENT OF GEORGIA

ON THE EXCHANGE AND MUTUAL PROTECTION OF

CLASSIFIED INFORMATION



The Council of Ministers of the Republic of Albania and the Government of Georgia (hereinafter referred to as the “Parties”);

Having agreed to hold talks on political and security-related issues and to broaden and enhance their political, military and economic co-operation;

Taking into consideration the changes in the political situation in the world and recognizing the important role of their mutual co-operation for the stabilization of peace, international security and mutual confidence;

Realizing that effective co-operation may require exchange of Classified Information between the Parties;

Desiring to create a set of rules regulating the mutual protection of Classified Information applicable to any agreements or documents containing or involving Classified Information and Classified Contracts, which will be concluded or exchanged between the Parties and/or Contractors and Subcontractors of the Parties in future or have been concluded or exchanged until entering into force of this Agreement;

Mutually respecting the sovereignty, equality, territorial integrity, security and interests of their states;

Have agreed as follows:

Article 1 Object and Scope

1. The purpose of this Agreement is to ensure protection of Classified Information, which is designated as the information containing state secret in accordance with the legislation in force in the states of the Parties and which is exchanged or created in the process of co-operation between the Parties.
2. This Agreement shall be applicable to any agreements or documents containing or involving Classified Information and Classified Contracts, which shall be concluded or exchanged between the Parties and/or Contractors and Subcontractors of the Parties in future, or have been concluded or exchanged until entering into force of this Agreement.

Article 2 Definitions

For the purposes of this Agreement:



1. **“Classified Information”** means any oral or written information regardless of the type/means of recording media, and any material object or document involving information, which is designated as the information containing state secret in accordance with the legislation in force in the states of the Parties;
2. **“Classified Contract”** means a contract (subcontract) between a Party and a Contractor or a Contractor and a Subcontractor, which involves the information containing state secret or on the basis of which such information is created, remade or stored;
3. **“Contractor/Subcontractor”** means an individual or a legal entity possessing legal capacity to conclude contracts (subcontracts) and/or a party to a Classified Contract under the provisions of this Agreement;
4. **“Personnel Security Clearance”** means the determination by the Competent Security Authority that an individual is eligible to have access to Classified Information, in accordance with the legislation in force in the states of the Parties;
5. **“Facility Security Clearance”** means the determination by the Competent Security Authority that, from a security point of view, a facility has the physical and organizational capability to use and administrate Classified Information, in accordance with the legislation in force in the states of the Parties;
6. **“Need-to-know”** means the principle, according to which, access to Classified Information may only be granted to an individual who has a verified need to know such information in connection with his/her official duties, within the framework of which the information was released to the Receiving Party;
7. **“Third party”** means a state or an international organization, which is not a party to this Agreement;
8. **“Originating Party”** means the Party, which releases Classified Information to the Receiving Party;
9. **“Receiving Party”** means the Party, which receives Classified Information from the Originating Party;
10. **“Visitors”** mean official representatives of one Party who require to visit establishments and premises of the other Party engaged in activities involving Classified Information.



Article 3

Competent Security Authorities

1. The Competent Security Authorities responsible for the implementation of this Agreement are:
 - a) for the Republic of Albania – Classified Information Security Directorate (National Security Authority);
 - b) for Georgia – State Security Service of Georgia.
2. Both Competent Security Authorities, each within the jurisdiction of its own state, shall ensure the protection of Classified Information transmitted or generated in the course of the implementation of this Agreement.
3. In order to achieve and maintain comparable standards of security, the respective Competent Security Authorities shall, on request, provide each other with information about their security standards, procedures and practices for the protection of Classified Information.
4. The Parties shall inform each other, through diplomatic channels, of any modification concerning their Competent Security Authorities.

Article 4

Equivalence of Security Classification Levels

1. Classified Information shall be assigned one of the following equivalent security classification levels:

For the Republic of Albania:	For Georgia:	Equivalent in English:
TEPËR SEKRET	განსაკუთრებული მნიშვნელობის	TOP SECRET
SEKRET	სრულიად საიდუმლო	SECRET
KONFIDENCIAL	საიდუმლო	CONFIDENTIAL
I KUFIZUAR	შეზღუდული სარგებლობისათვის	RESTRICTED

2. The period of classification of the exchanged Classified Information shall be defined in accordance with the legislation in force in the state of the Originating Party.
3. The Receiving Party shall neither declassify the Classified Information, nor use a lower security classification level, without a prior written consent of the Originating Party.



Article 5

Protection of Classified Information

1. Access to the Classified Information shall be granted only to those individuals who have need-to-know and who have been granted Personnel Security Clearance, or been authorized to access Classified Information in accordance with the legislation in force in the state of the appropriate Party.
2. The Receiving Party shall take the responsibility not to transmit Classified Information received under this Agreement to the third party, without a prior written consent of the Originating Party.
3. The Receiving Party shall assign Classified Information a level of protection equivalent to that assigned by the Originating Party in accordance with the equivalence given in Article 4.
4. The Receiving Party shall not use the Classified Information for any other purpose than the one for which it was provided.
5. The Receiving Party, according to the legislation in force in its state, shall protect rights such as patents, copyrights, also professional or commercial secrets contained in Classified Information.

Article 6

Security Clearances

1. A determination on granting Personnel and Facility Security Clearances shall be consistent with the legislation in force in the state of the respective Party and shall be based on the results of vetting procedures.
2. The Parties shall recognise the Personnel and Facility Security Clearances issued in accordance with the legislation in force in the state of the other Party.

Article 7

Visits

1. Visits requiring access to Classified Information shall be subject to prior consent of the Competent Security Authority of the host Party. Competent Security Authority of one Party at least three weeks prior to the planned visit must inform the Competent Security Authority of the other Party on the visit.
2. The request for visit shall contain the following information:



- a) name and last name of the visitor, date and place of birth, passport and/or ID number;
 - b) nationality/citizenship of the visitor;
 - c) position title of the visitor and name of the organization represented;
 - d) appropriate Personnel Security Clearance of the visitor;
 - e) purpose, proposed working program and planned date of the visit;
 - f) names of organizations and facilities requested to be visited;
 - g) other data if agreed upon by the Competent Security Authorities.
3. The Competent Security Authorities of the Parties shall approve the list of visitors who may repeat visits within twelve months for the purpose of carrying out the Classified Contract. The terms of specific visits shall be directly arranged by the Competent Security Authorities.
 4. Each Party shall guarantee personal data protection of visitors in accordance with the legislation in force in the state of the respective Party.

Article 8 **Transmission of Classified Information**

1. Classified Information shall normally be transmitted through diplomatic channels or through other channels previously agreed upon by the Competent Security Authorities.
2. The Receiving Party shall confirm the receipt of the Classified Information in writing.
3. The Parties may transmit Classified Information by electronic means in accordance with security procedures mutually agreed by the Competent Security Authorities.
4. Delivery of large items or quantities of Classified Information shall be agreed in writing by Competent Security Authorities on a case-by-case basis.

Article 9 **Translation and Reproduction of Classified Information**

1. Translation and reproduction of the Classified Information is permitted only under the need-to-know principle. Original and translation/reproduction of Classified Information are equally protected. The number of translations/reproductions may be limited or excluded by the Originating Party.
2. Translation/reproduction of Classified Information is conducted only by appropriately cleared individuals.



3. Classified Information marked as ТЕРЕК SEKRET/ გახსაკუთრებული მნიშვნელობის/ TOP SECRET shall not be reproduced by the Receiving Party and shall be translated only after a written consent is received from the Competent Security Authority of the Originating Party.

Article 10

Destruction and Return of Classified Information

1. Classified Information shall be destroyed, if:
 - a) it cannot be protected, in accordance with this Agreement, during crisis situation;
 - b) the Originating Party requires its destruction.
2. Classified Information shall be destroyed insofar as to prevent its reconstruction in whole or in part. Destruction shall be carried out in accordance with the legislation in force in the states of the Parties.
3. The Originating Party shall be informed on the destruction as soon as possible through channels mutually agreed by the Competent Security Authorities.
4. Upon request, Classified Information shall be returned to the Originating Party.

Article 11

Loss or Compromise

1. The Receiving Party shall immediately inform the Originating Party on all losses or compromises, as well as on possible losses or compromises of Classified Information, and shall initiate an investigation to determine the circumstances thereto.
2. The Receiving Party shall forward the results of an investigation and the information on measures taken to prevent recurrence of such events to the Originating Party. The Receiving Party may authorize the Originating Party to participate in an investigation.

Article 12

Classified Contracts

1. The Party, wishing to conclude a Classified Contract with a Contractor/Subcontractor in the state of the other Party, or wishing to authorize one of its own Contractors/Subcontractors to conclude a Classified Contract in the state of the other Party within a classified project, shall obtain a prior written consent



from the Competent Security Authority of the other Party that the proposed potential Contractor/Subcontractor holds an appropriate Facility Security Clearance.

2. The responsibility of the Contractor/Subcontractor to protect the Classified Information includes, at least, its obligation to:
 - a) disclose the Classified Information only to those individuals who have been granted appropriate Personnel Security Clearance and who have a need-to-know;
 - b) transmit the Classified Information by the means in accordance with the provisions of this Agreement;
 - c) elaborate procedures and mechanisms to inform its Competent Security Authority on any changes which may arise regarding Classified Information either because of the change in its classification level or because the protection of Classified Information is no longer necessary;
 - d) define procedures for visits of the personnel of one of the Parties to the other Party;
 - e) inform its Competent Security Authority on any actual, attempted or suspected unauthorised access to the Classified Information;
 - f) use the Classified Information received only for the purposes related to the subject matter of the Classified Contract;
 - g) comply with the procedures established by the respective legislation in force in the states of the Parties on the destruction of Classified Information.
3. A notification on any Classified Contract shall be forwarded in advance to the Competent Security Authority of the Party, where the work is to be performed.
4. A copy of the security section of any Classified Contract shall be forwarded to the Competent Security Authority of the Party, where the work is to be performed. The Competent Security Authority is responsible for determination and administration of the necessary measures regarding the implementation of Classified Contract.

Article 13 **Expenses**

Each Party will cover the expenses incurred to a Party with respect to this Agreement concerning the implementation of security measures set herein, unless Parties agree otherwise on a case-by-case basis.



Article 14 Settlement of Disputes

Any dispute regarding the interpretation or application of this Agreement shall be resolved between the Competent Security Authorities of the Parties through consultations or, in the case such a settlement is impossible to reach, between duly authorized representatives of the Parties through negotiations and shall not be referred to any national or international tribunal or third party.

Article 15 Final Provisions

1. This Agreement shall be concluded for an indeterminate period of time and shall enter into force upon the receipt of the last written notification through diplomatic channels by the Parties, confirming the completion of internal procedures necessary for its entry into force.
2. Each Party may terminate the application of this Agreement by a written notification on the termination of the Agreement communicated to the other Party through diplomatic channels. The application of the Agreement shall be terminated 6 (six) months after the receipt of the notification. Notwithstanding the termination of this Agreement, all Classified Information transmitted pursuant to this Agreement shall continue to be protected or shall be destroyed in accordance with the provisions of this Agreement.
3. This Agreement may be amended and supplemented by mutual agreement of the Parties. Such amendments and supplements, which are an integral part of this Agreement, shall be concluded as a separate document. It shall enter into force in the same manner as this Agreement.

Done at Tbilisi, on 18 September 2018, in two original copies, each in the Albanian, Georgian and English language. All texts are equally authentic. In case of any divergence in interpretation of the provisions of this Agreement, the text in English shall prevail.

FOR THE COUNCIL OF
MINISTERS OF THE REPUBLIC
OF ALBANIA

FOR THE GOVERNMENT OF
GEORGIA



DEKRET
Nr. 279, datë 31.7.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 79/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Gjeorgjisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM
Nr. 498, datë 1.8.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 285, DATË 19.5.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK”,
TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2, 13, pika 1, shkronja “a”, 14, pika 3, 17, pikat 1 e 2, 21, pika 4, 23, shkronjat “c” dhe “gj”, 33, pika 2, 34, pika 2, 35, pika 3, 41, pika 2, 42, pikat 1 e 3, shkronja “a”, 43, pikat 1, 4, shkronja “a”, e 7, 44, pika 1, 50, pikat 1, 2 e 7, 54, pika 1, 56, pika 4,

57, pikat 1 e 2, shkronja “c”, 58, pika 2, 71, pikat 1 e 2, shkronja “c”, 72, pika 1, 74, pika 1, 76, pika 3, 78, pika 3, 82, pikat 1 e 5, 93, pika 5, 109, pika 1, 110, pika 3, 111, pika 1, 112, pika 2, 113, pika 1, 114, pika 5, 115, pika 2, 116, pika 4, 122, pika 1, 124, pikat 2, 3 e 6, 125, pikat 1 e 2, 131, pika 2, e 132, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin bashkëlidhur vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në pikën 2, të nenit 2, “Dokumentimi i procesit”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën “c”, pas fjalëve “... dhe specifikimeve teknike ...” shtohen “... /termat e referencës ...”.

2. Në fund të shkronjës “l” shtohen fjalët “... sipas parashikimeve të LPP-së.”.

3. Shkronja “ll” ndryshohet, si më poshtë vijon:
“ll) Raportin për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve në LPP.”.

Neni 2

Në nenin 3, “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin publik dhe që shfuqizon direktivën 2004/18/KE”, të ndryshuar. Numri CELEX 32014L0024, *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian*, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 65–242.

- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga subjektet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE”, të ndryshuar. Numri CELEX 32014L0025, *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian*, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 243–374.

- Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave

administrative, në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, të ndryshuar. Numri CELEX 31989L0665, *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian*, seria L, nr. 395, datë 30.12.1989, f. 33–35.

- Direktivën e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992, “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit”, të ndryshuar. Numri CELEX 31992L0013, *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian*, seria L, nr. 76, datë 23.3.1992, f. 14–20



1. Në pikën 3, në fjalinë e dytë, paragrafi i parë, fjalët “... nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës ...” zëvendësohen me “... nga miratimi i detajimit të buxhetit ...”.

2. Në fund të pikës 3 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kur procedura e prokurimit kryhet nga organi qendror blerës apo ofruesi i shërbimit privat në emër dhe për llogari të autoritetit/entit kontraktor, ky i fundit përzgjedh njërin prej tyre, sipas rastit, në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit.”.

3. Në paragrafin e tretë, të pikës 5, fjalët “... e krijimit të tij në sistem ...” zëvendësohen me “... nga dërgimi i tij për publikim në sistem ...”.

Neni 3

Në pikën 5, të nenit 4, “Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit”, pas fjalëve “... të kryer nga organi qendror blerës ...”, shtohen “... apo ofruesit të shërbimit të prokurimit privat ...”.

Neni 4

Në nenin 6, “Buletini i Njoftimeve Publike”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në fund të paragrafit të dytë, të pikës 1, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në fund të çdo muaji, një kopje elektronike e buletineve të njoftimeve publike respektive, të publikuara çdo të hënë, i dërgohet Bibliotekës Kombëtare.”.

2. Shkronja “c”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në bazë të nenit 78, të LPP-së”.

Neni 5

Në pikën 3, të nenit 7, “Rregulla të përgjithshme për formën dhe për mënyrën e shpalljes së njoftimeve”, pas fjalëve “... të argumentimit të specifikimeve teknike ...” shtohen “.../termat e referencës ...”.

Neni 6

Neni 11, “Kufijtë monetarë”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11 Kufijtë monetarë

1. Kufijtë monetarë janë vlera monetare në bazë të të cilave përcaktohen rregullat procedurale, kryesisht në përcaktimin e afateve kohore në procedurat e prokurimit publik të sektorit klasik e sektorial për punë, shërbime, mallra, si dhe konkurset e projektimit.

2. Kufijtë monetarë ndahen në:

a) kufiri i lartë monetar për sektorin klasik dhe kontratat sektoriale;

b) kufiri i ulët monetar për sektorin klasik dhe kontratat sektoriale;

c) kufiri monetar për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike;

ç) kufiri monetar për prokurimet me vlerë të vogël.

3. Vlerat e kufijve monetarë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të LPP-së.

4. Për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, si dhe për artikuj e shërbime protokollare, sipas legjislacionit në fuqi, përcaktohen rregulla të posaçme me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 7

Në pikën 2, të nenit 20, “Njoftimet e konkursit të projektimit”, pas nënndarjes “...- numrin dhe vlerën e çmimeve” shtohet nënndarja “... - vlerën e përafërt për hartimin e projektit të zbatimit, nëse është rasti”.

Neni 8

Në nenin 23, “Njoftimi i modifikimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kur autoriteti/enti kontraktor modifikon një kontratë ose marrëveshje kuadër të lidhur në përfundim të procedurave që parashikon LPP-ja dhe këto rregulla, duhet të pasqyrojë modifikimin në sistemin e prokurimit elektronik.”.



2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Autoriteti/enti kontraktor, në rast se ka modifikuar marrëveshjen kuadër apo kontratën, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 127, të LPP-së, duhet të dërgojë për publikim një njoftim për ndryshimin e marrëveshjes kuadër apo kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj, në Buletin e Njoftimeve Publike, brenda 5 (pesë) ditëve, nga data në të cilën ka bërë modifikimin e kontratës fillestare.”.

Neni 9

Në nenin 24, “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalja e dytë, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.”.

2. Në pikën 4, fjalët “... mund të konvertojë ...” zëvendësohen me fjalën “... konverton ...”, si dhe fjalët “... monedhë ndërkombëtare ...” zëvendësohen me “... monedhë e huaj ...”.

Neni 10

Neni 25, “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 25

Kriteret e kualifikimit

1. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të këtij ligji, për sa kërkohet nga autoriteti/enti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Këto kriterë synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.

2. Në procedurat e prokurimit me faza, operatori ekonomik, në fazën e parë, duhet të plotësojë kriteret për kualifikim, të parashikuara në nenin 76, si dhe nenin 77, të LPP-së, për sa kërkohet nga

autoriteti/enti kontraktor për t’u kualifikuar në fazën tjetër.

3. Autoritetet/entet kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77 të LPP-së, si edhe në hartimin e specifikimeve teknike, sipas parashikimeve të nenit 36, të LPP-së, të zbatojnë, përveç këtyre rregullave për prokurimin publik, edhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë vijon:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficiencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.”.

Neni 11

Në nenin 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.”.

b) Pas shkronjës “k” shtohen shkronjat “l” dhe “ll”, me këtë përmbajtje:

“l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.”.

2. Paragrafi i parë, i pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i



kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuara me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.”

Neni 12

Në pikën 7, të nenit 30, “Sigurimi i ofertës”, fjalët “... sipas pikës 6, të këtij neni, ...” zëvendësohen me “... sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 6, të këtij neni ...”.

Neni 13

Në nenin 32, “Njoftimi i fituesit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit. Në rastin e procedurave të prokurimit, që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.”

2. Në pikën 2, fjalët “... në sistemin e prokurimit elektronik ...” zëvendësohen me “... sipas pikës 1, të këtij neni, ...”.

3. Në pikën 3, pas fjalëve “Njoftimi i fituesit për kontratën ...” shtohen “... sipas pikës 1, të këtij neni, ...”.

4. Në pikën 4, pas fjalëve “Njoftimi i fituesit për marrëveshjen kuadër ...” shtohen “... sipas pikës 1, të këtij neni, ...”.

5. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Pas përfundimit të afateve të ankimit ose procesit të ankimit, nëse ka një të tillë, autoriteti/enti kontraktor harton njoftimin e fituesit të procedurës me të cilin njofton operatorin ekonomik fitues për vijimin e hapave të mëtejshëm drejt nënshkrimit të kontratës apo marrëveshjes kuadër. Këto njoftime përmbajnë informacionin e përcaktuar në pikat 3 dhe 4, të këtij neni.”

Neni 14

Në pikën 1, të nenit 36, “Sigurimi i kontratës”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në fjalinë e tretë, fjalët “... e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari ...” zëvendësohen me “... të licencuara nga autoritetet kompetente ...”.

2. Pas fjalisë së dytë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor.”

Neni 15

Në nenin 38, “Njoftimi i anulimit”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, autoriteti ose enti kontraktor harton njoftimin e anulimit, i cili dërgohet për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe u komunikohet të gjithë kandidatëve ose ofertuesve. Në rastin e procedurave të prokurimit, që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Me publikimin e këtij njoftimi, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit, sipas parashikimeve në LPP dhe në këto rregulla.”

2. Në pikën 2, pas fjalëve “Njoftimi i anulimit ...” shtohen “... sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, ...”.



Neni 16

Në paragrafin e fundit, të pikës 5, të nenit 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pas fjalëve “... e shoqëruar me fatura tatimore ...” shtohen “... të deklaruara në organet tatimore ...”.

Neni 17

Në nenin 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në paragrafin e dytë, të pikës 4, pas fjalëve “... fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ...” shtohen “... dhe të deklaruara në organet tatimore ...”.

2. Fjala e pestë, e shkronjës “a”, të pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.”.

Neni 18

Në pikën 3, të nenit 41, “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në paragrafin e dytë, pas fjalëve “... ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ...” shtohen “... dhe të deklaruara në organet tatimore ...”.

2. Paragrafi i katërt ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit, do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

Neni 19

Në nenin 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në shkronjën “c”, të pikës 2, fjalët “... dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence” ...” zëvendësohen me “... dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme ...”.

2. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”.

Neni 20

Në nenin 45, “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2.1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) çmimin e bursës në datën kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date.”.

b) Në fund të pikës 2.1 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“APP-ja publikon çmimet e bursës së dërguar për publikim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.”.

2. Paragrafi i dytë, i pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në rastin kur oferta ekonomike më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është, si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po – janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... – janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend zbritës zbatohet formula, si më poshtë:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1;$$



Pk1 _____ pikët e kriterit që vlerësohet;
Vmink1 _____ vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet;

Pmaxk1 _____ pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet;

Ok1 _____ treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës zbatohet formula, si më poshtë:

$$Pk1 = Ok1 \times Pmaxk1 / Vmaxk1$$

Vmaxk1 _____ vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet;

Pmaxk1 _____ pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet;

Ok1 _____ treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.”.

3. Pas pikës 8 shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë: “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik.

Formula e llogaritjes është: Oferta më e mirë = X + Y

Pesha për propozimin teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)

Pesha për propozimin ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)

a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- i. përvojën për punë të ngjashme të konsulentit;
- ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;
- iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Nënkriteret e kritereve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet.

b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe – Pikët për propozimin ekonomik;

Çu – Çmimi më i ulët i ofruar;

Ç – Çmimi ofertues i radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët);

Pe = 100 x Çu/Ç (çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik).”.

Neni 21

Shkronja “d”, e pikës 2, të nenit 46, “Llojet e procedurave të prokurimit”, shfuqizohet.

Neni 22

Në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 52, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, hiqen fjalët “... shërbimit të konsulencës ...”.

Neni 23

Neni 54, “Shërbim konsulence”, shfuqizohet.

Neni 24

Pas paragrafit të dytë, të pikës 4, të nenit 56, “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur në përlllogaritjen e fondit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij procesi, por vetëm treguesit e çmimeve, të cilët dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.”.

Neni 25

Në pikën 7, të nenit 62, “Rregulla për prokurimin e marrëveshjes kuadër”, pas fjalës “... epidemitë ...” shtohet “... pandemitë ...”.

Neni 26

Në nenin 64, “Llojet e marrëveshjes kuadër”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i fundit, i pikës 3, shfuqizohet.

2. Pas paragrafit të parë, të pikës 4, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë. Në rast të kundërt, autoritetet/entet kontraktore mund të lidhin



marrëveshje kuadër me ata operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy.”.

Neni 27

Në nenin 65, “Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 3, pas fjalëve “ ... njoftimin e fituesit ...” shtohen “ ... pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit ...”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet/ent kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës, njoftimi i lidhjes së kontratës së parë brenda marrëveshjes kuadër do të dërgohet për publikim nga ky i fundit në sistemin e prokurimit elektronik, ndërsa njoftimi për lidhjen e kontratave të tjera të lidhura gjatë një viti kalendarik (minikontratave), do të krijohen dhe do të dërgohen për publikim nga vetë autoriteti kontraktor përfitues.”.

Neni 28

Në fund të pikës 2, të nenit 66, “Ndryshimi i palëve/përfundimi i marrëveshjes”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur kontrata e bazuar në marrëveshjen kuadër të lidhur me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ndërpritet për faj të operatorit ekonomik, marrëveshja kuadër përfundon, në kushtet kur nuk ka më operator ekonomik palë në këtë marrëveshje.”.

Neni 29

Në nenin 67, “Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në përputhje me nenin 53 të LPP-së dhe me qëllim realizimin dhe përdorimin më të mirë të fondeve publike, Këshilli i Ministrave krijon me vendim, organin qendror blerës, i cili do të kryejë procedura prokurimi në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore sipas sektorëve

përkatës, të përcaktuara në vendimin e krijimit të tij. Veprimtaria, që organi qendror blerës do të kryejë, duhet të jetë në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe çdo legjislacioni tjetër të zbatueshëm në fuqi.”.

b) Pika 2.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.1. Këshilli i Ministrave, sipas pikës 2, të nenit 53, të LPP-së, mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës apo si ofrues të shërbimit të prokurimit që do të zhvillojë procedurën e prokurimit për objekte të caktuara.”.

Neni 30

Në nenin 73, “Titullari i autoritetit/entit kontraktor”, bëhen këto shtesa:

1. Në nënndarjen e dytë, të pikës 1, pas fjalëve “... të përfshira në procesin e prokurimit ...” shtohen “... dhe zbatimin e kontratës ...”.

2. Në pikën 3 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në çdo rast, titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të sigurohet që zyrtarët/nëpunësit e prokurimit të jenë pjesë në vetëm një prej grupeve të punës që do të merren me procesin e prokurimit deri në shpalljen e fituesit pas përfundimit të afateve të ankimit.”.

Neni 31

Në nenin 74, “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “j”, e pikës 3, shfuqizohet.

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Specialisti i fushës ose struktura e posaçme kryen detyrat e mëposhtme, sipas rastit:

a) hartimi i specifikimeve teknike;

b) përlllogaritja e fondit limit;

c) hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetin teknik;

ç) hartimi i kriterëve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;

d) përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i livrimit).

Në rast se detyrat nuk janë kryer nga specialisti i fushës ose struktura e posaçme, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit/komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, për objektin që prokurohet.”.



Neni 32

Në pikën 1, të nenit 75, “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e prokurimit të kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet.”.

Neni 33

Pas nenit 75 shtohet neni 75/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 75/1

Profesionalizimi i prokurimit publik

1. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik harton kurrikulat e trajnimit, organizon dhe zhvillon modulet e trajnimit në lidhje me prokurimin publik, me cilësi dhe profesionalizëm.

2. Kurrikulat e trajnimit për prokurimin publik organizohen në 4 nivele të njohurive, si më poshtë:

- a) niveli bazë;
- b) niveli mesatar;
- c) niveli i avancuar;
- ç) niveli ekspert.

3. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike është institucioni përgjegjës për organizimin e trajnimeve e të testeve, në lidhje me prokurimin publik dhe pajisjen me certifikatën e trajnimit për nivelin përkatës.

4. Personat përgjegjës për prokurimin, si edhe personat e punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin, nëse ka, brenda një autoriteti/enti kontraktor kanë detyrimin të pajisen me certifikatën e njohurive në këtë fushë, të paktën në nivelin bazë, sipas parashikimeve në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me përshkrimet e punës dhe procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të nxjerra në zbatim të ligjit për nëpunësin civil.

Parashikimet e akteve të mësipërme janë të vlefshme edhe për personat përgjegjës për prokurimin apo personat e punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin në autoritete/ente

kontraktore, që nuk janë subjekt i legjislacionit për nëpunësin civil.

5. Autoriteti/enti kontraktor duhet t'u mundësojë personave përgjegjës dhe personave të punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin të marrin pjesë në trajnimin e detyrueshëm bazë në fushën e prokurimit publik dhe/ose dhënien e testimi për pajisjen me certifikatën e njohurive.

6. Autoriteti/enti kontraktor e trajton kohën e shpenzuar nga personi përgjegjës apo punonjësi i përfshirë në procesin e prokurimit si orar të zakonshëm pune dhe e kompenson atë njëjloj sikurse ta kishte shpenzuar atë kohë në punë.

7. Kohëzgjatja e një kurrikule trajnimi është 40 (dyzet) orë.

8. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike mban Regjistrin e Personave të Certifikuar në fushën e prokurimit publik dhe një kopje të tij ia dërgon Agjencisë së Prokurimit Publik në mënyrë periodike ose sa herë që kërkohet nga kjo e fundit.

9. Personat përgjegjës ose personat e punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin, nëse ka, mund të vendosin të zhvillojnë trajnimin e detyrueshëm bazë ose të kryejnë direkt testimin për marrjen e certifikatës. Me kalimin me sukses të testimi të zhvilluar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, personi përgjegjës apo personi i punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin pajiset me certifikatën përkatëse, që i përkon nivelit të certifikatës, sipas pikëve të marra në testim. Moskalimi me sukses i testimi nga ana e personit përgjegjës apo personit të punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin detyron këta të fundit që të rikryejnë trajnimin e detyrueshëm bazë, në përfundim të të cilit duhet të kryhet përsëri testimi për marrjen e certifikatës.

10. Certifikata e trajnimit, pas kalimit me sukses të testimi përkatës nga personi përgjegjës apo personi i punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin, është e vlefshme për 5 (pesë) vjet. Në përfundim të afatit 5-vjeçar, personi përgjegjës apo personi i punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin është i detyruar që të trajnohet/të testohet lidhur me rinovimin e certifikatës apo për të kaluar në një nivel më të lartë certifikimi.

11. Personat, të cilët posedojnë një diplomë master ose doktoraturë në fushën e prokurimit publik, janë të përjashtuar nga detyrimi për certifikim nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, por regjistrohen automatikisht në Regjistrin



e Personave të Certifikuar me paraqitjen e diplomës, si më poshtë:

- a) personat me diplomë master, nivel i avancuar;
- b) personat me doktoraturë, nivel eksperti.

12. Punonjësit e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, përveç punonjësve që punojnë në pozicione mbështetëse, janë të përjashtuar nga detyrimi për certifikim nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, por regjistrohen automatikisht në Regjistrin e Personave të Certifikuar me paraqitjen e njoftimeve nga titullarët e institucioneve, si më poshtë vijon:

- a) punonjësit e sapopunësuar dhe me deri 2 (dy) vjet eksperiencë pune, nivel bazë;
- b) punonjësit me eksperiencë pune 2–5 vjet, nivel mesatar;
- c) punonjësit me eksperiencë pune 5–7 vjet, nivel i avancuar;
- ç) punonjësit me eksperiencë pune mbi 7 vjet, nivel eksperti.

Eksperiencë pune për punonjësit e cilësuar në këtë pikë do të konsiderohet si eksperiencë në këto institucione, ashtu edhe në çdo institucion/sector privat në fushën e prokurimit.

13. Në rast se personat e sipërpërmendur dëshirojnë të kalojnë në një nivel më të lartë certifikimi në fushën e prokurimit publik, mund të ndjekin trajnimin sipas kurrikulës përkatëse ose të hyjnë direkt në testim sipas kalendarit të testeve të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

14. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Agjencinë e Prokurimit Publik, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, harton rregulla procedurale të detajuara lidhur me organizimin e procesit, ku përcaktohen procedurat dhe kriteret për organizimin e trajnimeve, testeve dhe dhënien e certifikatave në fushën e prokurimit publik.”

Neni 34

Në nenin 77, “Urdhri i prokurimit”, shtohet paragrafi i parë, me këtë përmbajtje:

“Urdhri i prokurimit” është akti administrativ i nxjerrë nga autoriteti ose enti kontraktor pas fazës përgatitore të procesit për prokurimin e një objekti të caktuar dhe që konsiderohet momenti i fillimit të procedurës konkrete të prokurimit për objektin.”

Neni 35

Në pikat 4 dhe 5, të nenit 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pas fjalëve “... dhe specifikimeve teknike ...” shtohen “... termat e referencës ...”.

Neni 36

Në nenin 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës “a” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shumat në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.”.

b) Në fund të shkronjës “b” shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shumat në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.”.

c) Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shumta në fjalë. Bën përjashtim nga kjo rregull situata kur shumta në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.”.

2. Paragrafi i tretë, i pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është, si më poshtë vijon:

O – Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme



$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On/N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuara $< .. PR$ rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.”.

3. Në paragrafin e gjashtë, të pikës 5, togfjalëshi “... 5 (pesë) ditë ...” zëvendësohet me “... 7 (shtatë) ditë ...”.

Neni 37

Pika 2, e nenit 83, “Njoftimi i fituesit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit, në përputhje me nenin 97, të LPP-së, pas publikimit të të cilit nisin afatet e ankimit.”.

Neni 38

Pas pikës 4, të nenit 88, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në prokurimin e kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, këto të fundit nuk kanë detyrimin e deklarimit të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim. Secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit të nenit 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.”.

Neni 39

Në nenin 94, “Paraqitja e ankesave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “... i cili ka ose ka pasur interes ...” shtohet fjala “... të ligjshëm ...”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”.

3. Paragrafi i dytë dhe i tretë, i pikës 3, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës për llogari të buxhetit të shtetit. Dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën, duhet t’i bashkëlidhet ankimit që ankimuesi

do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.”.

4. Paragrafi i dytë, i pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Njoftimi bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.”.

Neni 40

Pika 1, e nenit 95, “Veprimet paraprake të Komisionit të Prokurimit Publik”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këto rregulla e publikon në bazën e të dhënave, përmes ndërveprimit me sisteme të treta, së bashku me të dhënat e mëposhtme:

a) Ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) Të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;

c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Neni 41

Në pikën 1, të nenit 96, “Veprimet paraprake të autoritetit/entit kontraktor”, hiqen fjalët “... me shkrim ...”.

Neni 42

Pas pikës 4, të nenit 97, “Afatet për paraqitjen e ankesave”, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës, sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”.



Neni 43

Në nenin 99, “Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas emërimit “Komisionit të Prokurimit Publik” shtohen fjalët “... në Sistemin e Ankesave Elektronike ...”.

2. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

a) Në fjalinë e parë, togfjalëshi “... 7 (shtatë) ditë ...” zëvendësohet me “... 10 (dhjetë) ditë ...”;

b) Në fjalinë e dytë, togfjalëshi “... 5 (pesë) ditë ...” zëvendësohet me “... 7 (shtatë) ditë ...”.

Neni 44

Paragrafi i katërt, i pikës 1, të nenit 101, “Hapat për shqyrtimin e ankesave në autoritetin/entit kontraktor”, shfuqizohet.

Neni 45

Në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 103, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik”, pas fjalës “... të nenit ...” shtohet togfjalëshi “... 110 dhe ...”.

Neni 46

Në nenin 107, “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, bëhen këto ndryshime:

1. Fjala e parë, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë, për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti/enti kontraktor për kontratat e lidhura në përfundim të procedurave me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlerë të vogël, të cilat kanë kohëzgjatje jo më pak se 6 muaj, duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi.”.

2. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

a) Në fjalinë e dytë, të paragrafit të parë, fjalët “... brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj ...” zëvendësohen me “... brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës ...”.

b) Paragrafi i dytë dhe paragrafi i katërt shfuqizohen.

c) Në paragrafin e tretë, togfjalëshi “... brenda 7 (shtatë) ditëve ...” zëvendësohet me “... brenda 10 (dhjetë) ditëve ...”.

3. Pika 5 shfuqizohet.

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Komisioni i ngritur nga titullari i autoritetit/entit kontraktor, sipas legjislacionit të fushës në fuqi është struktura përgjegjëse për ndjekjen me përpikëri të ecursisë së zbatimit të kontratës, për t’u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës, në përputhje me kushtet e prokuruarra dhe me legjislacionin në fuqi.

Struktura përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka këto përgjegjësi:

a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;

b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;

c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;

d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;

dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për problematikat e hasura apo për shkelje të dispozitave kontraktuale, duke propozuar edhe masat konkrete;

e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/ përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;

ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;

f) përgatit formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, i cili, pasi miratohet nga titullari, i përcillet APP-së.

Titullari i autoritetit/entit kontraktor, pa cenuar detyrimet që lindin nga legjislacioni i fushës, mund të ngarkojë në urdhrin përkatës një ose disa nga anëtarët e strukturës përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për kryerjen e detyrave të veçanta, sipas shkronjave të sipërpërmendura.”.



5. Pikat 7 dhe 8 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“7. Në përfundim të kontratës, struktura e ngarkuar për ndjekjen e kontratës përgatit formularin e raportimit për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, duke pasqyruar në të të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, modifikimet e kryera në kontratë, nëse është rasti, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, sipas rastit, si dhe informacion për likuidimin ose jo të kontratës. Për çdo situatë të raportuar në lidhje me ecurinë e zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor pasqyron në formularin e raportimit rrethanat, arsyet dhe argumentimin përkatës mbi bazën e dispozitave ligjore, ku bazohet situata konkrete në zbatimin e kontratës.

8. Formularët e planit të zbatimit të kontratës dhe raportimit për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve të këtij neni, do të jenë në përputhje me udhëzimet e APP-së.”.

6. Fjalja e dytë, e pikës 9, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit, sipas faturave periodike të shitjes, të lëshuara sipas legjislacionit tatimor në fuqi në lidhje me momentin e lëshimit të faturës, mbështetur në çmimin e bursës në ditën para lëshimit të faturës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, i livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të ditës para lëshimit të faturës.”.

7. Në pikën 10, fjalët “... , të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, dërguar ...” zëvendësohen me “... , të publikuar nga APP-ja pas dërgimit të këtij çmimi për publikim ...”.

Neni 47

Neni 108, “Raportimi në rastet e mospërmbyshjes së detyrimeve kontraktuale”, shfuqizohet.

Neni 48

Shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 109, “Rastet për kryerjen e hetimit administrativ”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) për monitorimin e zbatimit të kontratës së nënshkruar bazuar në dokumentacionin e administruar nga autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe jo më vonë se 3 (tre) vjet nga përfundimi i zbatimit të saj.”.

Neni 49

Paragrafi i parë, i pikës 3, të nenit 110, “Procedura hetimore në procesin e përjashtimit të operatorëve ekonomikë”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Çdo kërkesë e paraqitur në APP nga të tretët duhet të jetë e nënshkruar dhe e shoqëruar me dokumentacionin provues.

Në rast se kërkesa e paraqitur nuk është e nënshkruar dhe e shoqëruar me dokumentacionin provues, dërguesit i kthehet mbrapsht për plotësim.”.

Neni 50

Pas paragrafit të dytë, të pikës 2, të nenit 111, “Verifikimi i kryerjes së procedurave të prokurimit dhe monitorimi i zbatimit të kontratave”, shtohet fjalja, me këtë përmbajtje:

“Çdo kërkesë e paraqitur në APP nga të tretët duhet të jetë e nënshkruar dhe e shoqëruar me dokumentacionin provues.”.

Neni 51

Në nenin 113, “Refuzimi për bashkëpunim”, pas emërimit “Agjencinë e Prokurimit Publik” shtohen fjalët “... ose moszbatimi brenda afatit i vendimeve të këtyre të fundit në mënyrë të pajustifikuar ...”.

Neni 52

Dispozita kalimtare

1. Procedurat e prokurimit të filluara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi vazhdojnë sipas rregullave të prokurimit publik, në bazë të të cilave ato kanë filluar.



2. Në rast se një autoritet/ent kontraktor, pas marrjes së autorizimit nga Këshilli i Ministrave, ka negociuar drejtpërdrejt një marrëveshje konsulence me subjekte ndërkombëtare, sipas parashikimeve në pikën 2, të nenit 52, të ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dërgon një njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik për periudhën kalimtare 3-vjeçare.

3. Kryerja e trajnimit të detyrueshëm bazë dhe certifikimi pas kalimit me sukses të testimit përkatës për personat përgjegjës apo zyrtarët e strukturave organizative të prokurimit publik, sipas parashikimeve të nenit 33, të këtij vendimi, do të kryhet brenda 2 (dy) viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Gjatë 2 (dy) viteve të para pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike merr masa për zhvillimin e testimeve në intervale të rregullta 2-mujore.

Neni 53

Dispozita të fundit

Ngarkohen autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 505, datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 725, DATË 2.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1, e kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Agjencia e Zhvillimit të Territorit (Agjencia) është person juridik publik me vetëfinancim, në varësi të Kryeministrit, e cila ka përgjegjësi zhvillimin e territorit dhe kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.

Burimet e financimit për Agjencinë janë:

- a) të ardhurat e krijuara nga vetë Agjencia;
- b) buxheti i shtetit;
- c) burime të tjera të ligjshme.”.

2. Në pikën 4, të kreut II, “Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë”, numri “45” zëvendësohet me “120”.

3. Pika 1, e kreut III, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Agjencisë”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Agjencia kryen funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit. Në këtë kuadër, Agjencia ka këto përgjegjësi:

- a) organizon mbledhjet e KKTU-së;
- b) përgatit dhe administron dokumentacionin që shqyrtohet nga KKTU-ja, në fushën e planifikimit e të zhvillimit të territorit, duke drejtuar dhe bashkërenduar procesin me autoritetet e tjera përgjegjëse, në nivel qendror dhe/ose vendor, sipas parimit të shërbimit me një ndalesë;

c) ndërvepron me institucionet e tjera shtetërore, në emër dhe për llogari të kërkuesit, gjatë procedurës së shqyrtimit, miratimit, lëshimit të autorizimeve, lejeve dytësore, të cilat janë të domosdoshme, në funksion të miratimit të lejes së ndërtimit;

ç) pranon njoftimin për fillimin e punimeve, si dhe kryen, rast pas rasti, pasi ta ketë vlerësuar, në varësi të kompleksitetit që paraqet projekti i miratuar nga KKTU-ja, monitorimin e procesit të zbatimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të tyre;

d) vë në zbatim vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit e monitoron zbatimin e tyre nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera përgjegjëse;

dh) kryen monitorimin e zhvillimeve në territor, si dhe përgatit raportin përkatës për të informuar Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit e



autoritetet e tjera, që kanë përgjegjësi në fushën e zhvillimit të territorit;

e) administron dokumentacionin që shoqëron propozimet e paraqitura nga IKMT-ja, si dhe kryen përgatitjet për shqyrtimin e këtij dokumentacioni nga KKTU-ja, gjatë zhvillimit të procedurave për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje me qëllim fitimi;

ë) kryen komunikimin me palë të treta për llogari të KKTU-së;

f) administron informacionin në sistemin elektronik të lejeve (*e-leje*), duke pasur akses në këtë sistem, në drejtim të verifikimit të të dhënave parësore e dytësore, që kjo bazë të dhënash grumbullon, si dhe të përmirësimit të procedurave që kryhen nëpërmjet sistemit;

g) kryen trajnime të subjekteve fizike dhe juridike, publike dhe private, lidhur me përdorimin e procedurat, që kryhen nëpërmjet sistemit *e-leje*;

gj) komunikon dhe shpërndan në sistemin elektronik të lejeve vendimet e dokumentet e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit;

h) ofron mbështetje ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore në proceset e tyre të zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

i) përfaqëson Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit në të gjitha çështjet, objekt shqyrtimi gjyqësor, që kanë lidhje me vendimet e miratuara dhe procedurat e kryera nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit lidhur me zhvillimin e territorit;

j) nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për koordinimin ndërinstitutional dhe mënyrën e pagesës e të alokimit të tarifave me institucionet e tjera shtetërore, të cilat shqyrtojnë, miratojnë, lëshojnë autorizime, leje dytësore, të cilat janë të domosdoshme, në funksion të miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit.”.

4. Në fund të pikës 1, të kreut IV, “Bashkëpunimi ndërinstitutional”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në këtë kuadër, Agjencia ndërvepron me institucionet e tjera shtetërore, në emër dhe për llogari të kërkuarit, gjatë procedurës së shqyrtimit, miratimit, lëshimit të autorizimeve, lejeve dytësore, të cilat janë të domosdoshme, në funksion të miratimit të lejes së ndërtimit.”.

5. Kudo në përmbajtje të vendimit, shkurtësisht “KKT” zëvendësohet me “KKTU”.

6. Pikat 1 dhe 2, të kreut VI, “Dispozita kalimtare dhe të fundit”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shtimi i numrit të punonjësve prej, gjithsej, 120 vetash, sipas pikës 4, të këtij vendimi, do të hyjë në fuqi më 1 janar 2025.

2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 509, datë 1.8.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 600, DATË 13.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PRONËSINË E RRUGËVE SHTETËRORE DHE KALIMET E PRONËSISË NDËRMJET ENTEVE PRONARE TË RRUGËVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, dhe të nenit 4, të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pavarësisht transferimit të inventarit të rrugëve ndërmjet enteve pronare, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi, kontratat për investime dhe mirëmbajtje të lidhura para hyrjes në fuqi të vendimit nr. 234, datë 17.4.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 600, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”, i



vazhdojnë efektet deri në përfundim të afatit të tyre.”.

2. Ngarkohet Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 516, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 308, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
PAKETAVE TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE QË DO TË
FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR NË
SHËRBIMIN SPITALOR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kontraktimi me institucionet shëndetësore jopublike për financimin e paketave bëhet në përputhje me legjislacionin e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, duke aplikuar nëpërmjet platformës *e-Albania*.”.

2. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Fondi administron Regjistrin Kombëtar të Paketave të Shërbimeve Shëndetësore të autorizuar në institucionet shëndetësore jopublike, Regjistrin Kombëtar të Paketës Shëndetësore të Hemodializës

në qendrat e ofrimit të këtij shërbimi nga kontrata e partneritetit publik privat, si dhe regjistrin e të dhënave për paketat shëndetësore të realizuara në nivel kombëtar.”.

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 518, datë 1.8.2024

**PËR DHËNIEN E STATUSIT TË
VEÇANTË “INVESTITOR NË
STRUKTURË AKOMODUESE ME 5 YJE,
STATUS SPECIAL” SUBJEKTIT “E & A
INVESTMENTVLORË” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33/1, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me 5 yje, status special” subjektit “*E & A Investment Vlorë*” sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 520, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 641, DATË 1.10.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
EKSPORTIN E MBETJEVE DHE
KALIMIN TRANSIT TË MBETJEVE JO
TË RREZIKSHME E TË MBETJEVE
INERTE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, fjalët “... përgatit dhe dorëzon ...” zëvendësohen me “... dërgon elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” ...”.

2. Shkronja “a”, e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) vendimit nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”;

3. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Ministria ngarkon në portalin unik qeveritar “e-Albania” konfirmimin/pëlqimin me shkrim, të përcjellë nga autoriteti kompetent, të destinacionit dhe/ose të transimit.”.

4. Pika 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“24. Të dhënat e ruajtura sipas pikës 23, të këtij vendimi, pas nënshkrimit elektronik nga personi fizik/juridik raportohen në ministri dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit çdo 6 (gjashtë) muaj gjatë afatit të autorizimit, nëpërmjet sistemit elektronik.

Raportimi i të dhënave të ruajtura sipas afatit të autorizimit përbën kusht për shqyrtimin e aplikimit pasardhës. Ministria krijon Regjistrin Kombëtar të

Eksportit të Mbetjeve për eksportin dhe transimin e mbetjeve. Format i regjistrit dhe mënyra e administrimit të tij miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

5. Në pikën 26, fjalët “... 30 ditë kalendarike.” zëvendësohen me “... 20 (njëzet) ditë pune.”.

6. Pas pikës 35 shtohet pika 35/1, me këtë përmbajtje:

“35/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i aplikimit dhe tërheqja e autorizimeve për eksportin, transimin e mbetjeve, si dhe raportimi sipas pikës 24, të këtij vendimi, bëhet në ministrinë përgjegjëse për mjedisin.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 521, datë 1.8.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 692, DATË 5.10.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
‘KRITERET PËR PAJISJEN ME
CERTIFIKATË PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË UDHËRRËFYESIT
TURISTIK, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË
DHE KODIN E ETIKËS SË TYRE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 692, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:



“2/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, zbatohet në momentin që sistemi i certifikimeve në turizëm do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, certifikata dhe dokumenti identifikues i udhërrëfyesit turistik nënshkruhen nga ministri ose personi i autorizuar prej tij.”.

2. Në rregulloren bashkëlidhur vendimit bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në nenin 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. shkronjat “b” dhe “dh”, të pikës 3, shfuqizohen;

ii. pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Komisioni është përgjegjës për sigurimin e vërtetimit se aplikuesi nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë.”;

b) Në pikën 1, të nenit 6, togfjalëshi “... brenda 45 ditëve ...” zëvendësohet me “... brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve ...”;

c) Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

i. pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Certifikata dhe dokumenti identifikues gjenerohen elektronikisht me vulë elektronike të ministrisë përgjegjëse për turizmin.”;

ii. në shkronjën “a”, të pikës 3, togfjalëshi “... e adresën e udhërrëfyesit ...” hiqet;

iii. shkronja “dh”, e pikës 3, shfuqizohet;

ç) Nenet 8, 9, 10 dhe 11 shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 522, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 371, DATË 11.6.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
DORËZIMIN E MBETJEVE TË
RREZIKSHME DHE TË DOKUMENTIT
TË DORËZIMIT TË TYRE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 26, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të Faqe| 16614

ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Mbetje të rrezikshme klasifikohen mbetjet e shënuara me shenjë yll “*”, të miratuara me vendimin nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”.”.

2. Në pikën 3, fjalët “... vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve” ...” zëvendësohen me “... vendimin nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve” ...”.

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Dorëzuesi, për çdo transfertë, i dërgon elektronikisht nga një kopje të dokumenteve të dorëzimit të plotësuar e të nënshkruar elektronikisht nga palët Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*.”.

4. Pika 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“20. Dokumenti i dorëzimit përmban kodin unik, i cili përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e kodit unik miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas paraqitjes së kërkesës në mënyrë elektronike nga dorëzuesi. Agjencia Kombëtare e Mjedisit shqyrton kërkesën dhe verifikon të dhënat e kërkuarit nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe licencën III.2.B. Në rast se nga verifikimi konstatohet se dokumentacioni i depozituar nga kërkuari nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit unik qeveritar *e-Albania*, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit e të pasaktësive të konstatuara brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga dita e njoftimit. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës së ndarë elektronikisht përmes portalit unik qeveritar *e-Albania*. Kërkuari njoftohet përmes portalit unik qeveritar *e-Albania* për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet elektronikisht.”.



5. Në pikën 21, togfjalëshi "...10 (dhjetë) ditëve pune ..." zëvendësohet me "... 5 (pesë) ditëve pune ...".

6. Pika 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"24. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon dhe administron një bazë të dhënash për kodet unike. Baza e të dhënave shërben si pjesë e Regjistrit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve të Rrezikshme, që mban Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Baza e të dhënave për kodet unike përmban elementet e mëposhtme:

a) Institucionin administrues, Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

b) Të dhënat parësore, si: lloji i mbetjes, kodi i mbetjes sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, gjendja/forma fizike e mbetjes (e gaztë/e lëngët/ngurtë/pluhur/llum/përzier);

c) Të dhënat dytësore, si numri i regjistrimit, NIPT-i, numri i identifikimit të lejes së mjedisit, numri i identifikimit të licencës III.2.B;

ç) Dhënësit e informacionit, si personi fizik/juridik, QKB-ja;

d) Ndërveprimi QKB - Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

dh) Personat e interesuar, si personi fizik/juridik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit."

7. Pas pikës 25 shtohet pika 25/1, me këtë përmbajtje:

"25/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*, zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dokumenti i dorëzimit depozitohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 523, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 302, DATË 10.5.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
KRITERET E USHTRIMIT, TË
MIRATIMIT E MONITORIMIT TË
VEPRIMTARIVE KËRKIMORE-
SHKENCORE NË ZONAT E
MBROJTURA MJEDISORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 81/2017, "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 302, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e ushtrimit, të miratimit e monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në zonat e mbrojtura mjedisore", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Subjektet/individët, të cilët kërkojnë të ushtrorjnë veprimtarinë kërkimore-shkencore, dërgojnë elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar *"e-Albania"* kërkesën për miratim pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM)."

2. Në pikën 5, fjalët "...me shkrim..." hiqen.

3. Në pikën 6, togfjalëshi "...10 ditëve pune..." zëvendësohet me "...7 (shtatë) ditëve pune..."

4. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Në rast se nga ana e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura konstatohet se kërkesa e paraqitur nga subjekti kërkues/aplikuesi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, e njofton atë përmes portalit unik qeveritar *"e-Albania"*, duke i kërkuar subjektit kërkues/aplikuesit për të bërë plotësimet e nevojshme brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuesi njoftohet përmes portalit unik qeveritar *"e-Albania"* për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet bashkë me aktet



e tjera, dokumente me vulë elektronike. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura vendos për miratimin ose jo të kërkesës brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i këtij afati.”.

5. Në fund të pikës 10 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Njoftimi për miratimin apo refuzimin e së drejtës së ushtrimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.”.

6. Fjalia e dytë, e pikës 15, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Konkretisht, aplikuesit dërgojnë elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” raportin përkatës me rezultatet e arritura gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie.”.

7. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania” zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i kërkesës dhe i dokumentacionit për miratimin e ushtrimit të veprimtarive kërkimore-shkencore, si dhe i raportit mbi rezultatet e arritura gjatë veprimtarisë kërkimore-shkencore bëhet pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 524, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 285, DATË 29.4.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRITERET E VENDOSJES DHE TË
FUNKSIONIMIT TË STACIONEVE
SEZONALE TË ANKORIMIT/
BREGËZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 285, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) vetëdeklarim për mjetet e financimit të projektit”;

b) në shkronjën “ç”, fjala “vërtetimin...” zëvendësohet me “vetëdeklarimin...”;

c) shkronjat “d” dhe “dh” shfuqizohen.

2. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Komisioni është përgjegjës për sigurimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

a) vërtetimit se aplikuesi nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra penale, që lidhen me veprimtarinë profesionale, si person fizik ose juridik, ortak apo aksionar i shoqërisë;

b) vërtetimet se aplikuesi ka përmbushur detyrimet në lidhje me pagesat e taksave e të tatimeve, si dhe detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.”.

3. Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“15. Dokumentacioni i përcaktuar në pikat 11, 11/1, 12, 13 dhe 14, të këtij vendimi, depozitohet elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.”.

4. Pas pikës 24 shtohet pika 24/1, me këtë përmbajtje:

“24/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet në momentin që sistemi i certifikimeve në turizëm do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i kërkesës, dokumentacioni shoqërues për vendosjen dhe funksionimin e stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit depozitohen nga subjekti si dhe procedura e shqyrtimit të aplikimeve bëhet pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 525, datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 284, DATË 29.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, PROCEDURAVE DHE KRITEREVE PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E EKSPERTIT NË FUSHËN E PYJEVE DHE KULLOTAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun IV, të vendimit nr. 284, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, togfjalëshi “... brenda 15 ditëve pune ...” zëvendësohet me “... brenda 7 (shtatë) ditëve pune ...”.

2. Në pikën 5, togfjalëshi “... brenda 5 (pesë) ditëve ...” zëvendësohet me “... brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 526, datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 229, DATË 23.4.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR TRANSFERIMIN E MBETJEVE JO TË RREZIKSHME DHE INFORMACIONIT QË DUHET TË PËRFSHIHET NË DOKUMENTIN E TRANSFERIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 11, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen e elektronike”, dhe të pikës 11, të nenit 21, të ligjit nr.

10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Mbetje jo të rrezikshme klasifikohen mbetjet që nuk shënohen me shenjën yll “*”, të miratuara me vendimin nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, të cilit më poshtë i referohemi me emërtimin “Katalogu i mbetjeve”.”.

2. Pikat 13, 14 dhe 15 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“13. Krijuesi, grumbulluesi dhe pritësi i mbetjeve raportojnë në mënyrë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, informacion lidhur me mbetjet jo të rrezikshme të transferuara, referuar dokumentit të transferimit, të paktën 1 (një) herë në 6 muaj.

14. Dokumenti i transferimit përmban kodin unik, i cili përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë e kodit unik miratohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit pas paraqitjes së kërkesës, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, nga personi që transferon mbetjet jo të rrezikshme tek pritësi. Agjencia Kombëtare e Mjedisit shqyrton kërkesën dhe verifikon të dhënat e kërkuarit nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe licencën III.2.B. Në rast se nga verifikimi konstatohet se dokumentacioni i depozituar nga kërkuari nuk është i plotë apo ka pasaktësi, e njofton atë përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit e të pasaktësive të konstatuara brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga dita e njoftimit. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda këtij afati përbën shkak për mospranimin e kërkesës, e cila, në këtë rast, quhet se nuk është regjistruar. Kërkuari njoftohet përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*” për arsyet e mospranimit dhe kërkesa i kthehet.



15. Agjencia Kombëtare e Mjedisit miraton pjesën e parë të Kodit Unik brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”.”.

3. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Agjencia Kombëtare e Mjedisit krijon dhe administron një bazë të dhënash për kodet unike. Baza e të dhënave shërben si pjesë e Regjistrimit Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve jo të Rrezikshme, që mban Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Baza e të dhënave për kodet unike përmban elementet e mëposhtme:

a) institucionin administrues, Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

b) të dhënat parësore, si: lloji i mbetjes, kodi i mbetjes sipas Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, gjendja/forma fizike e mbetjes (e gaztë/e lëngët/e ngurtë/pluhur/llum/përzier);

c) të dhënat dytësore, si: numri i regjistrimit, NIPT-i, numri i identifikimit të lejes së mjedisit, numri i identifikimit të licencës III.2.B;

ç) dhënësit e informacionit, si personi fizik/juridik, QKB-ja;

d) ndërveprimi QKB–Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

dh) personat e interesuar, si personi fizik/juridik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit.”.

4. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1, me këtë përmbajtje:

“19/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, raportimi i informacionit lidhur me mbetjet jo të rrezikshme të transferuara bëhet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 527, datë 1.8.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 63, DATË 7.2.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND, PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 27, pika 5, e 29, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 63, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... është 6 (gjashtë).” zëvendësohen me “... është 10 (dhjetë).”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 528, datë 1.8.2024****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 62, DATË 7.2.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2024, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 62, datë 7.2.2024, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) në paragrafin e parë, fjalët “...gjithsej 1183...” zëvendësohen me “...gjithsej, 1187...”;
b) në shkronjën “a”, shifra “6” bëhet “10”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 529, datë 1.8.2024****PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR TË PËRZGJEDHJES PËR TRUPËN E NIVELIT TË LARTË DREJTUES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Lirimin e z. Erind Mërkuri nga detyra e anëtarit të Komisionit Kombëtar të Përzgjedhjes për Trupën

e Nivelit të Lartë Drejtues dhe përfundimin e mandatit të tij 5-vjeçar përpara kohe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 531, datë 1.8.2024****PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2024, MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT PËR SEZONIN TURISTIK 2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në zërin “Shpenzime korrente”, të programit buxhetor “Arti dhe kultura”, i shtohet fondi prej 48 137 500 lekë (dyzet e tetë milionë e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekësh, për promovimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistiko-kulturore, përgjatë sezonit turistik 2024.

2. Efekti financiar, prej 48 137 500 lekë (dyzet e tetë milionë e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 13, datë 10.7.2024****PËR VITIN SHKOLLOR 2024–2025
NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Objekti**

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i masave dhe i veprimtarive që ndërmarrin institucionet e sistemit arsimor parauniversitar gjatë vitit shkollor 2024–2025.

**Neni 2
Regjistrimi i nxënësve dhe pajisja me tekste
shkollore**

1. Regjistrimet dhe transferimet e nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar (IAP) të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me procedurat e përcaktuara në urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023, të MAS-it, “Për miratimin e rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar”.

2. Drejtoritë e IAP-ve të afishojnë në vend të dukshëm listën e teksteve shkollore, ku shënohen: titulli, shtëpia botuese, çmimi i tekstit për çdo klasë, vendi ku do të shpërndahen tekstet dhe periudha e shpërndarjes sipas një grafiku për çdo klasë.

3. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, drejtuesit e IAP-ve dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi:

a) procesin e shpërndarjes dhe të shitjes së teksteve shkollore për të gjithë nxënësit para fillimit të procesit mësimor;

b) procesin e pajisjes me tekste shkollore falas dhe në përdorim falas për klasat I–IX të arsimit bazë, si dhe pajisjen me tekste shkollore falas të të gjitha kategorive të përcaktuara në VKM-në përkatëse.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) të raportojë zyrtarisht në MAS për ecurinë e procesit të pajisjes së të gjithë nxënësve me tekste shkollore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3**Ndalimi i përdorimit të telefonit celular**

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare të marrin masa për zbatimin e urdhrit nr. 493, datë 30.7.2018, të MASR-së, “Për mospërdorimin e telefonit celular gjatë procesit mësimor në shkollë” dhe të udhëzimit nr. 34, datë 16.11.2018, të MASR-së, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare”.

2. Masat për ndalimin e përdorimit të telefonit celular gjatë procesit mësimor të pasqyrohen në rregulloren e brendshme të institucionit arsimor parauniversitar.

Neni 4**Shërbimi psikosocial (SHPS)**

1. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) të marrin masa për funksionimin e shërbimit psikosocial, në zbatim të urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020, të MASR-së, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit nga shërbimi psikosocial”, i ndryshuar.

2. DRAP-të dhe ZVAP-të të monitorojnë zbatimin e planit të punës të njësive të SHPS-së dhe të raportojnë në AKAP, në muajt janar dhe qershor 2025, për realizimin e tij. AKAP-ja të raportojë në MAS në muajt shkurt dhe korrik 2025.

3. Puna e punonjësve të SHPS-së në institucionet e arsimit parauniversitar të mbështetet në “Manuali i punës për punonjësit e shërbimit psikosocial në sistemin arsimor parauniversitar”, “Standardet e përgjithshme profesionale të shërbimit psikosocial shkolror”, “Parimet për etikën profesionale të



shërbimit psikosocial shkollor”, të miratuara me shkresën e MAS-it nr. 2116/2 prot., datë 8.7.2022.

KREU II VEPRIMTARIA NË INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

Neni 5 **Arsimi parashkollor**

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore (kopshtet), të ndjekin me përparësi detyrat si vijon:

a) marrjen e masave për krijimin e mjediseve të jashtme e të brendshme të institucioneve arsimore parashkollore të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse, që të mundësojnë zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve;

b) marrjen e masave për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve 3–6 vjeç në arsimin parashkollor;

c) regjistrimin me përparësi në institucionet arsimore parashkollore të fëmijëve me nevoja të veçanta: nga familjet në nevojë, nga pakicat kombëtare (romë, egjiptianë etj.) dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;

ç) ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi;

d) hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga mësuesit e arsimit parashkollor në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale të specializuara;

dh) ngritjen në çdo institucion arsimor parashkollor të bordit, këshillit të prindërve, këshillit të mësuesve dhe komisionit të etikës e sjelljes, sipas legjislacionit në fuqi;

e) trajtimin me përparësi nga këshillat e mësuesve dhe nga rrjetet profesionale të temave të mëposhtme:

i. standardet e zhvillimit dhe të të nxënësve të fëmijëve 3–6 vjeç;

ii. kurrikula me kompetenca dhe planifikimi sipas saj në arsimin parashkollor;

iii. portofoli i të nxënësve;

iv. korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor;

v. standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor;

vi. standardet profesionale për drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore;

vii. arsimi gjithëpërfshirës;

viii. mësimdhënia me fëmijën në qendër;

ix. ndërgjegjësimi i prindërve për rëndësinë e frekuentimit të kopshtit nga fëmijët e moshës 3-6 vjeç;

x. zhvillimi profesional i mësuesit dhe i drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor, faktor në rritjen e cilësisë së shërbimeve për fëmijët 3–6 vjeç;

ë) zbatimin e urdhrit nr. 199, datë 7.5.2024, të MAS-it, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit” dhe të “Udhëzuesit metodologjik për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit”.

Neni 6 **Arsimi bazë**

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, të ndjekin me përparësi:

a) marrjen e masave për krijimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme për një shkollë miqësore, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, të cilat nxisin edukimin dhe krijimin e një raporti të qëndrueshëm me mjedisin dhe natyrën;

b) regjistrimin me përparësi të fëmijëve nga shtresat në nevojë, pakica kombëtare, me aftësi të kufizuara, të kthyer nga emigracioni, të fëmijëve viktimë apo viktimë të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore etj.;

c) zbatimin e udhëzimit nr. 14, datë 10.7.2023, të MAS-it, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”;

ç) zbatimin e planeve mësimore për klasën e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt, miratuar me urdhrin nr. 203, datë 25.4.2023;

d) zbatimin e planit mësimor për klasat V–IX, sipas shtojcës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi;

dh) zbatimin e planit mësimor për pakicat kombëtare në arsimin bazë, miratuar me urdhrin nr. 531, datë 9.9.2022;

e) zbatimin e planit mësimor për Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë, të rishikuar, konfirmuar



nga MAS-i, me shkresë nr. 7254/1 prot., datë 10.11.2022, në kuadër të përfshirjes së lëndës së gjuhës angleze dhe të lëndës së TIK-ut që në klasën e parë të shkollave të arsimit bazë;

ë) zbatimin e planit mësimor për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, miratuar me urdhrin nr. 694, datë 18.11.2022;

f) zbatimin në shkollat e pajisura me *Smartlab* të programit mësimor të lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasën e parë, miratuar me urdhrin nr. 304, datë 10.6.2022;

g) zbatimin në shkollat e pajisura me *Smartlab* të programit mësimor të lëndës së TIK-ut për klasën e dytë, të miratuar me shkresën nr. 2608/2, datë 8.5.2023;

gj) zbatimin e planit mësimor të klasave të caktuara me drejtim artistik në arsimin bazë, miratuar me urdhrin nr. 305, datë 16.6.2023;

h) zbatimin e planit mësimor për arsimin bazë me kohë të pjesshme, miratuar me urdhrin nr. 284, datë 28.7.2021;

i) zbatimin e planit mësimor të shkollave speciale miratuar me urdhrin nr. 366, datë 21.9.2021;

j) zbatimin e programit kombëtar për aktivitete jashtë orarit mësimor, “Art, zeje, sport”, miratuar me VKM-në nr. 606, datë 14.9.2022, të ndryshuar, në ato IAP që janë pjesë e këtij programi;

k) zbatimin e urdhrit nr. 600, datë 19.10.2023, të MAS-it, “Për miratimin e udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6–9)” dhe raportimin nga AKAP-ja në MAS për ecurinë e orientimit për karrierën, brenda datës 1.7.2025.

l) zbatimin e urdhrit nr. 267, prot., datë 3.6.2024 “Për miratimin e programit mësimor të lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasën e tretë”;

ll) zbatimin nga institucionet arsimore të planit të veprimtimit të hartuar prej tyre (DRAP/ZVAP) për mbështetjen e arsimimit në gjuhën amtare të fëmijëve të pakicave kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

m) planifikimin dhe realizimin e veprimtarive të veçanta në institucionet publike të arsimit parauniversitar ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave kombëtare;

n) hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara;

nj) ndjekjen dhe përfundimin e arsimit bazë nga fëmijët romë, sipas deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për romët;

o) raportimin në AKAP dhe në MAS, brenda afateve dhe kërkesave, të të dhënave statistikore në arsimin bazë, sipas pasqyrave të miratuara nga INSTAT-i;

p) funksionimin e rrjeteve profesionale të mësuesve, mësuesve ndihmës, mësuesve që japin mësim në klasat kolektive dhe të shërbimit psikosocial;

q) zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe të provimeve kombëtare të arsimit bazë, në zbatim të udhëzimeve dhe rregulloreve përkatëse;

r) trajnimin e rrjeteve profesionale të mësuesve të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave të natyrës, si dhe organizimin e veprimtarive për përgatitjen e nxënësve për vlerësimet ndërkombëtare PISA, PIRLS dhe TIMSS;

rr) koordinimin dhe realizimin e veprimtarive për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet ndaj përmbajtjeve të paligjshme dhe të dëmshme dhe parandalimin e dukurive negative në shkollë, në zbatim të udhëzimit të përbashkët të MAS-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me nr. 658, datë 23.9.2019, “Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij”;

s) sigurimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme;

sh) zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”, me vendimarrje të vetë shkollës, në varësi të kushteve dhe specifikave të saj;

t) zbatimin e veprimtarive në përputhje me urdhrin nr. 65, datë 13.2.2024, “Për realizimin e planit të aktiviteteve në kuadër të programit *e-twinning*, për periudhën 2024–2026, në përputhje me kushtet e marrëveshjes”;

th) planifikimin dhe realizimin e veprimtarive për parandalimin e dhunës në shkollë dhe raportimin periodik të çdo shkolle në ZVAP, DRAP, AKAP dhe MAS;



u) planifikimin dhe realizimin e veprimtarive që synojnë përgatitjen e nxënësve të klasave të nënta për Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe;

v) zhvillimin e veprimtarive brenda dhe jashtë klasës që synojnë njohjen dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në procesin mësimor;

x) mësimin e gjuhëve të huaja në arsimin bazë:

i. të sigurohet, brenda shkollës, vijimësia e gjuhës së huaj të parë, të nisur në klasën e parë të arsimit fillor, dhe të gjuhës së huaj të dytë, të nisur në klasën VI;

ii. të zbatohen memorandumet dhe marrëveshjet dypalëshe si vijon:

iii/1 Për gjuhën italiane, vijon zbatimi i memorandumit të mirëkuptimit miratuar më 18.5.2021 për programin “Iliria”. Planifikimi i shkollave që do të zhvillojnë gjuhën italiane, është kompetencë dhe përgjegjësi e ZVAP-ve;

iii/2 për gjuhën frënge, vijon zbatimi i angazhimeve në kuadër të aderimit në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe të Memorandumit të Partneritetit mbi “Bashkëpunimin Arsimit të Kuadrit Strategjik të Frankofonisë”;

iii/3 ZVAP-të Elbasan, Durrës, Korçë–Pustec, Shkodër dhe Tiranë, në shkollat e të cilave funksionojnë klasat mbështetëse për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, shqiptaro-franceze dhe shqiptaro-gjermane, të sigurojnë hapjen e klasave në shkollat e përcaktuara në memorandumet, duke filluar në klasën III të arsimit fillor dhe në klasën VI të arsimit të mesëm të ulët për fazën tranzitore;

iii/4 DRAP-të, për çdo ZVAP në varësi, të raportojnë planifikimin për secilën gjuhë të huaj në AKAP e cila, brenda datës 30 shtator 2024, raporton në MAS;

xh) zbatimin e urdhrit të përbashkët nr. 3348/1, datë 18.4.2018, të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”;

y) zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe raportimin çdo tre muaj nga AKAP-ja në MAS për ecurinë e kësaj nisme;

z) krijimin e klasave të profilizuara në sport në disiplina të ndryshme sportive, sipas kërkesave të nxënësve, vetëm në fillim të vitit shkollor dhe pas miratimit nga DRAP-ja;

zh) krijimin e klasave të arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë në zbatim të udhëzimit nr. 21, datë 8.9.2023, të MAS-it, “Për përcaktimin e rregullave dhe proceduarve për krijimin e klasave të arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë”.

Neni 7

Arsimi i mesëm i lartë

1. Për gjimnazet, DRAP-të, ZVAP-të dhe drejtuesit e gjimnazeve të ndjekin me përparësi:

a) marrjen e masave për krijimin e një mjedisi të jashtëm dhe të brendshëm për një shkollë miqësore, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse dhe të një raporti të ri dhe të qëndrueshëm me mjedisin dhe natyrën;

b) zbatimin e programit kombëtar për aktivitete jashtë orarit mësimor, “Art, zeje, sport”, miratuar me VKM-në nr. 606, datë 14.9.2022, të ndryshuar, në ato IAP që janë pjesë e këtij programi;

c) zbatimin e udhëzimit nr. 14, datë 10.7.2023, të MAS-it, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”;

ç) zbatimin e planeve mësimore si më poshtë:

i. plani mësimor i gjimnazit, i miratuar me shkresën nr. 12789/1 prot., datë 28.12.2017;

ii. plani mësimor i gjimnazit me kohë të pjesshme, i miratuar me shkresën nr. 7380 prot., datë 20.7.2016.

iii. plani mësimor për arsimin e mesëm të lartë të orientuar “Teknologji dhe TIK” për nxënësit që nuk dëgjojnë, miratuar me urdhrin nr. 113, datë 27.2.2023;

d) ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi.

dh) koordinimin në zbatim të marrëveshjes mes MAS-it dhe Komisionit Evropian për programin *e-twinning* dhe programin Erasmus+ për arsim dhe edukim, sipas urdhrit nr. 65, datë 13.2.2024, “Për realizimin e planit të aktiviteteve në kuadër të programit *e-twinning*, për periudhën 2024–2026”;

e) regjistrimin me përparësi të nxënësve nga pakica rome dhe egjiptiane dhe përfundimin prej tyre të arsimit të mesëm të lartë sipas deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për romët;

ë) raportimin në AKAP dhe MAS, brenda afateve dhe kërkesave, të të dhënave statistikore në



gjimnaze, sipas pasqyrave të miratuara nga INSTAT-i;

f) zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore bazuar në rregulloren e Maturës Shtetërore dhe udhëzimet përkatëse.

2. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me orientim gjuhësor të merren masat e mëposhtme:

a) të zbatojnë planin mësimor të miratuar me shkresën nr. 5415 prot., datë 26.5.2016;

b) t'i zgjedhin vetë tekstet shkollore për lëndën e gjuhës së huaj, nëse ato që janë në katalogun e teksteve shkollore 2024–2025, nuk përmbushin kërkesat kurrikulare të kësaj lënde.

3. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë të orientuar të merren masat për zbatimin e akteve të mëposhtme:

a) Plani mësimor për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me drejtim artistik, miratuar me urdhrin nr. 306, datë 16.6.2023;

b) Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive), shkolla “Loro Boriçi”, i miratuar me shkresën nr. 5418 prot., datë 26.5.2016;

c) Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive), shkolla “Benardina Qerraxhia”, i miratuar me shkresën nr. 4116/1 prot., datë 11.9.2020;

4. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me seksione shkollore dygjuhëshe të merren masat për zbatimin e akteve të mëposhtme:

a) marrëveshja nr. 6045 prot., datë 13.6.2016, midis ministrisë përgjegjëse për arsimin të Republikës së Shqipërisë dhe ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe zhvillimin ndërkombëtar të Republikës së Francës mbi “Bashkëpunimin në fushën e arsimit dygjuhësh”;

b) memorandum i mirëkuptimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë mbi funksionimin e seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-italiane, nënshkruar më 12.12.2019;

c) memorandum i bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë mbi seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman dhe planet mësimore për seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman, miratuar me shkresën nr. 7496 prot., datë 22.7.2016.

5. Për institucionet e arsimit të mesëm profesional të zbatohen:

a) urdhri nr. 281, prot., datë 6.6.2024, “Për miratimin e planeve mësimore të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional”;

b) fusha e kulturës profesionale në arsimin e mesëm profesional, për vitin shkollor 2024–2025, rregullohet me akte të posaçme në përputhje me ligjin nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

c) për Maturën Shtetërore Profesionale të zbatohet rregullorja e zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore, përfshirë dhe Maturën Shtetërore Profesionale dhe udhëzimet përkatëse, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

6. Për arsimimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur të zbatohet urdhri i përbashkët nr. 3348/1, datë 18.4.2018, i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”.

Neni 8

Arsimi parauniversitar privat

1. DRAP-të dhe ZVAP-të të realizojnë me përparësi detyrat si vijon:

a) të mbajnë kontakte me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat, t'i informojnë rregullisht për çdo ndryshim apo akt të ri ligjor dhe nënligjor në fushën e arsimit dhe t'i monitorojnë për realizimin e planeve dhe të programeve mësimore;

b) të kërkojnë dhe të administrojnë të dhëna statistikore që lidhen me procesin mësimor;

c) të bëjnë vlerësimin e kriterëve të licencimit dhe ushtrimit të veprimtarisë për çdo institucion arsimor dhe të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MAS.

ç) të sistemojnë nxënësit, në rast mbylljeje të institucioneve arsimore private.

2. Institucionet arsimore parauniversitare private të marrin masat e mëposhtme:

a) të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në fillim të vitit shkollor, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve, sipas statistikave të miratuara, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe planin vjetor të shkollës sipas formatit të parashikuar në rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;



b) të zbatojnë rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, për transferimin e nxënësve, si dhe udhëzimin nr. 28, datë 16.10.2023, “Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas”.

c) të realizojnë detyrimet e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit (regjistra, amza, evidenca për lëvizjet e nxënësve, rregullore e brendshme e kopshtit/shkollës, dëftesa, kontrata me prindërit etj.), sipas udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, të MASH-it, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar;

ç) institucionet mund ta ndërpresin veprimtarinë e tyre arsimore vetëm në fund të vitit shkollor. Për mbylljen e veprimtarisë arsimore duhet të njoftojnë institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, AKAP-në, MAS-in, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e plotë në ZVAP-të përkatëse.

3. Institucionet arsimore parauniversitare private ku mësimi zhvillohet në gjuhë të huaj, të bashkëpunojnë me ZVAP-të përkatëse për njoftimin në kohë të maturantëve të cilët dëshirojnë të vijojnë studimet e larta në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e procedurave të përcaktuara në rregulloren e Maturës Shtetërore të vitit përkatës.

KREU III

POLITIKA, STRATEGJI, MARRËVESHJE

Neni 9

Reduktimi i braktisjes shkollore

1. Për reduktimin e braktisjes shkollore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare të zbatojnë me përgjegjësi:

a) marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet MAS-it, MShMS-së dhe Ministrisë së Brendshme (MB), nr. 7522 prot., datë 12.7.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore”;

b) urdhrin e përbashkët nr. 292, datë 28.5.2019, të MAS-it, MB-së dhe MShMS-së, “Për miratimin e

rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:

a) të monitorojnë shkollat lidhur me raportimin e nxënësve braktisës dhe të atyre në rrezik braktisje;

b) të koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve pranë bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile për zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës dhe të fëmijëve në situatë rruge;

c) të ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve të ngujuar dhe zbatimin e procedurave të ndjekjes së arsimit bazë, sipas udhëzimit përkatës për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë;

ç) të raportojnë në DRAP dy herë në vit (në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor) punën e bërë për reduktimin e braktisjes shkollore. DRAP-të të raportojnë në AKAP, e cila përcjell raportin në MAS.

Neni 10

Organizimi dhe zhvillimi i praktikave profesionale

1. Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, DRAP-të, ZVAP-të dhe institucionet arsimore të zbatojnë urdhrin nr. 100, datë 25.2.2022, të MAS-it, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar.

2. DRAP-të dhe ZVAP-të:

a) publikojnë në faqen e internetit listën e institucioneve arsimore parauniversitare, publike dhe private, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale;

b) hartojnë listat e IAP-ve, publike dhe private, në juridiksion, në të cilat do të zhvillohet praktika profesionale, listat e praktikantëve dhe listat e mentorëve;

c) sigurojnë kryerjen e praktikës profesionale nga praktikantët, sipas procedurave të rregullores së praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit;

ç) monitorojnë organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në IAP, publike dhe private.



Neni 11

Shkolla qendër komunitare

1. Konsolidimi i shkollave qendra komunitare (ShQK), bazuar në standardet e shkollës si qendër komunitare në këto aspekte:

a) SHQK-të të vlerësohen për përmbushjen e standardeve dhe kriterëve të përcaktuara për SHQK-në.

b) Shkollat, pjesë e programeve të bashkëpunimit me partnerët Save the Children, World Vision, UNICEF, UNDP, të vijojnë të jenë pjesë e SHQK-së dhe të bashkëpunohet për përmbushjen e angazhimeve dypalëshe dhe të projekteve në proces.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:

a) të vlerësojnë SHQK-të në përputhje me kriteret;

b) të marrin masat e nevojshme për këshillimin, informimin, trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të mësuesve koordinatorë, strukturave të shkollës, grupeve nga komuniteti, në bashkëpunim me ZVAP-të, DRAP-të, AKAP-në dhe Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe partnerët;

c) të promovojnë praktikat më të mira të SHQK-ve dhe të shkëmbejnë përvojat mes shkollave;

c) të marrin masat për menaxhimin sa më efektiv të 10 orëve javore të planifikuara për SHQK-në;

d) të propozojnë në MAS për miratim shkolla të tjera që plotësojnë kriteret e ShQK-së.

Neni 12

Karta e Performancës

1. Për Kartën e Performancës të vitit shkollor 2023-2024 dhe për vitin shkollor 2024-2025:

a) në dërgimin e të dhënave që burojnë nga shkolla, të sqarohet edhe procedura e përpunimit të të dhënave siç është përcaktuar në udhëzuesin për Kartën e Performancës së shkollës;

b) institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mund të vendosin të kenë tregues rajonalë ose jo (p.sh.: të dhëna për lëndët me zgjedhje, arritjet e nxënësve me AK etj.);

c) çdo shkollë në arsimin parauniversitar, deri më 3.9.2024, të plotësojë kartën e performancës së shkollës për vitin shkollor 2023–2024, si dhe ta bëjë atë publike për prindërit dhe komunitetin;

c) ZVAP-të të verifikojnë të dhënat e dërguara nga shkollat deri më 10.9.2024;

dh) në fund të muajit shtator 2024, ZVAP-të të shpallin shkollat e suksesshme në zbatim të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;

e) shkollat të hartojnë kartën e performancës për vitin shkollor 2024–2025 me treguesit e përzgjedhur, bazuar në urdhrin nr. 157, datë 28.3.2022, të MAS-it, “Për miratimin e Kartës së Performancës së Shkollës dhe udhëzuesit të saj”;

ë) çdo shkollë e arsimit parauniversitar të llogarisë edhe ndryshimin në vlerë për treguesit e pasqyruar në kartën e performancës së vitit paraardhës.

Neni 13

Parandalimi i dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në institucionet arsimore

1. ZVAP-të dhe drejtoritë e IAP-ve të marrin masa për:

a) planifikimin vjetor të veprimtarive ndërgjegjësuere me fokus parandalimin dhe minimizimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në institucionet arsimore;

b) ngritjen e këndit “Stop dhunës në shkollë”;

c) ngritjen e ekupeve “antibulling” në çdo shkollë;

ç) monitorimin dhe përmirësimin e punës të komisioneve të disiplinës dhe të komisioneve të etikës dhe të sjelljes, për trajtimin e rasteve të çdo lloji dhune në institucionet arsimore;

d) organizimin e veprimtarive ndërgjegjësuere të datës 21 nëntor, “Ditës Kombëtare kundër bullizmit”;

dh) konsolidimin e rrjetit të mësuesve koordinatorë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në arsimin parauniversitar;

e) raportimin në DRAP, brenda datës 30.5.2025, sipas formateve të përcaktuara, të rasteve të dhunës në institucionet arsimore, të trajtuara nga komisionet e etikës, si dhe raportin informues për punën e bërë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve.

2. AKAP-ja, në bashkëpunim me ASCAP-in, harton raportin përmbledhës dhe e dërgon në MAS, brenda datës 1.7.2025.



Neni 14

Zbatimi i strategjive ndërsektoriale, planeve kombëtare të veprimit dhe projekteve

1. ASCAP-i, AKAP-ja dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në bazë të planit të veprimit për zbatimin e secilës strategji kombëtare ndërsektoriale:

- a) të caktojnë personat përgjegjës;
- b) të hartojnë plane pune vjetore me detyra dhe afate konkrete;
- c) të monitorojnë realizimin e veprimtarive;
- ç) të raportojnë rregullisht për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga këto strategji.

2. ASCAP-i dhe AKAP-ja të mbështesin dhe të raportojnë në MAS ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre, për strategjitë, planet kombëtare dhe projektet e mëposhtme:

a) Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 621, datë 22.10.2021;

b) Strategjia Kombëtare për Migracionin, 2024–2030 dhe Plan i Veprimit 2024–2026, miratuar me VKM-në nr. 271, datë 2.5.2024;

c) Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022–2026, plani i veprimit dhe pasaporta e indikatorëve, miratuar me VKM nr. 892, datë 27.12.2022;

d) Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Plan i Veprimit 2023–2025, miratuar me VKM-në nr. 81, datë 14.2.2023;

ç) Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plan i Veprimit 2020-2025, miratuar me VKM-në nr. 1034, datë 24.12.2020;

d) Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026, miratuar me VKM-në nr. 659, datë 3.11.2021;

dh) Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe plani i veprimit 2021–2024, miratuar me VKM-në nr. 1139, datë 24.12.2020;

e) Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030 dhe plani i veprimit, miratuar me VKM-në nr. 400, datë 30.6.2021;

ë) Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019–2024 dhe plani i veprimit, miratuar me vendimin nr. 47/2019 të Kuvendit të Shqipërisë;

f) Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025, miratuar me VKM-në nr. 1140, datë 24.12.2020, i ndryshuar;

g) Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2024, miratuar me VKM-në nr. 1117, datë 16.12.2020;

gj) Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025 dhe plani i veprimit, miratuar me VKM-në nr. 903, datë 24.12.2019;

h) Plan i Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025, miratuar me VKM nr. 276, datë 12.5.2021;

i) Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021–2025”, miratuar me VKM nr. 701, datë 18.11.2021;

j) Plan i Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit dhe plani i veprimit, miratuar me VKM-në nr. 412, datë 19.6.2019;

k) Projekti “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës dhe Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Ky projekt do të zbatohet në shkollat e përzgjedhura në bashkëpunim nga Këshilli i Europës dhe MAS-i;

l) Projekti “STEM” në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Fondacionit Vodafone Albania dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

ll) Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, për zbatimin e projektit “Element IT”, miratuar me VKM-në nr. 594, datë 7.9.2022;

m) Projekti “Shkollat për shëndetin”, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, miratuar me VKM-në nr. 521, datë 18.9.2021;

n) Projekti “QËNDRO” (Qëndroni në shkollë! Qëndroni në Shqipëri), në kuadër të bashkëpunimit me qeverinë italiane dhe UNICEF Shqipëri;

nj) Projekti “Panairi shkencor”, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar midis MAS-it dhe ShUKALB-it;

o) Projekti “Inteligenca artificiale për të rinjtë”, në përputhje me memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet MAS-it dhe Fondacionit Shqiptaro-



Amerikan për Zhvillim, me nr. 3877/1 prot., datë 3.6.2022.

Neni 15

Edukimi shëndetësor dhe mjedisor

1. DRAP-të, ZVAP-të dhe IAP-të të marrin masa për zbatimin me përparësi, të:

a) urdhrit të përbashkët nr. 335, datë 14.7.2021, midis MSHMS-së dhe MAS-it për miratimin e rregullores “Për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”;

b) urdhrit të përbashkët nr. 336, datë 14.7.2021, midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për miratimin e rregullores për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”.

2. DRAP-të, ZVAP-të dhe institucionet arsimore parauniversitare të sigurojnë:

a) që nxënësit e arsimit parauniversitar të mos ekspozohen ndaj reklamave të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore;

b) mbrojtjen e shëndetit të nxënësve, informimin e tyre dhe kushtet higjienike të mjediseve;

c) zhvillimin e veprimtarive për ndërgjegjësimin e nxënësve për ushqyerjen e shëndetshme;

ç) zhvillimin në IAP të veprimtarive jashtëshkollore dhe plotësuese në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, Ditës Botërore të Ujit dhe Ditës Botërore të Tokës;

d) zbatimin e projekteve të organizatave, shoqatave dhe individëve me qëllim kultivimin e vlerave të qytetarisë dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve në mjedis për, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij;

dh) zbatimin e nismës “Toka në shkollë” për krijimin në të gjitha shkollat të miniparcelave (kopshte të gjelbra në shkollë);

e) zbatimin e projekteve “Miq të ujit” dhe “Sfida botërore e monitorimit të ujit”, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara midis MAS-it dhe SHUKALB-it;

ë) zbatimin e nismës “Miku i mjedisit” në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bashkinë Tiranë, UNICEF dhe “Eco Tirana”.

Neni 16

Zbatimi i marrëveshjeve dhe memorandumëve

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MAS, për ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre për marrëveshjet dhe memorandumet e mëposhtme:

a) marrëveshja e bashkëpunimit nr. 1084 prot., datë 15.2.2023, ndërmjet MAS-it dhe Institutit për Studimin e Krimeve të Komunizmit, “Për koordinimin e veprimtarive të përbashkëta institucionale për informimin e nxënësve mbi krimet e komunizmit të kryera në Shqipëri gjatë periudhës 1944–1990”;

b) marrëveshja e bashkëpunimit nr. 1646 prot., datë 18.3.2021 ndërmjet MAS-it dhe Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish Sigurimit të Shtetit, në kuadër të zbatimit të politikave arsimore dhe të formimit historik të nxënësve.

c) marrëveshja e bashkëpunimit midis Federatës Botërore të Shahut, Federatës Shqiptare të Shahut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 4661/1, datë 18.6.2015, objekt i së cilës është implementimi i projektit “Mësime të shahut në shkollë”;

ç) marrëveshja e bashkëpunimit me nr. 1988/2, datë 14 prill 2021, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Albanian-American Development Foundation për zbatimin e programeve të “Junior Achievement of Albania”. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të koordinojë veprimtaritë që mundëson ky memorandum, duke u angazhuar në mbështetje të ekspertëve vendas dhe të huaj, të cilët do të zbatojnë aktivitetet e programeve të “Junior Achievement of Albania”;

d) memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, “Për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit mesëm i ulët parauniversitar”;

dh) marrëveshja e bashkëpunimit për Këshillimin e Karrierës për nxënësit e arsimit parauniversitar nr. 2996/2, datë 5.5.2022, midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë.

e) marrëveshja e bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Xhudos dhe Ministrisë së Arsimit dhe



Sportit nr. 9322, datë 12.11.2015, për zbatimin e projektit “Mësime të xhudos në shkollë”;

ë) marrëveshja e bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Hendbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4073, datë 18.4.2016, objekt i së cilës është zbatimi i projektit “Mësime të hendbollit në shkollë”;

f) marrëveshja e bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 1660, datë 12.12.2017, për zbatimin e projektit “Mësime të futbollit në shkollë (Grow 2020)”;

g) Programi “Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Brendshme, nr. 7638, datë 16.4.2014, si dhe edukimi i të rinjve me parimet e *fair-play* (garimi i drejtë) dhe rreziqet e dopingut ndaj shëndetit, dëmi që shkakton ai në vlerat etike të sportit, në zbatim të ligjit nr. 9242, datë 17.6.2004, “Për ratifikimin e Konventës Europiane Anti-doping 1989”;

gj) marrëveshje bashkëpunimi midis Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2028/1, datë 23.2.2018, për zbatimin e projektit “Mësime të basketbollit në shkollë”;

h) marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Organizatës Kombëtare Anti-doping dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit regjistruar në MAS me nr.1155/1, datë 29.5.2023;

i) memorandum i mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Korpusit të Pages, nënshkruar më datë 23.4.2024. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të informojnë institucionet arsimore, që:

i. të përfshijnë vullnetarin/en në takimet e organizuara në shkollë për procesin e bashkëmësimdhënies dhe të projekteve të ndryshme në interes të shkollës;

ii. të mbështesin mësuesit të marrin pjesë në trajnimet që zhvillon/sponsorizon Korpusi i Pages;

iii. të përfshijnë vullnetarin/en në organizimin dhe zbatimin e veprimtarive dhe të projekteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet;

iv. të mbështesin vullnetarin/en në zbatimin e nismës për të zhvilluar aftësitë në gjuhën angleze të mësuesve të lëndëve të tjera;

j) memorandum i bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016, dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, “Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë”, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të koordinojë veprimtaritë kulturore, artistike, figurative që mundëson ky memorandum.

Neni 17

Veprimtari plotësuese dhe jashtëshkollore

1. Në zbatim të VKM-së, nr. 324, datë 29.5.2024, “Për miratimin e kalendarit të integruar të veprimtarive në kuadër të vitit mbarëkombëtar të 80-vjetorit të Çlirimit”, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe IAP-të të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë veprimtaritë sipas kalendarit të miratuar.

2. Në zbatim të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, ZVAP-të dhe IAP-të të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë veprimtari me përfshirjen e të gjithë nxënësve, si më poshtë:

a) Olimpiadat kombëtare në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë;

b) Pajisja me “Medaljen e artë” të nxënësve të shkëlqyer në vite;

c) Kampionati Kombëtar i Shahut për arsimin 9-vjeçar, në bashkëpunimin me Federatën Shqiptare të Shahut. Faza e parë të zhvillohet në bazë shkolle në muajin dhjetor 2024, faza e dytë në bazë qarku në muajin shkurt dhe finalja në mars-prill 2025;

ç) Java Evropiane e Sportit, 23–30 shtator 2024;

d) Java Olimpikë (prill–maj);

dh) Dita Evropiane e Gjuhëve, 26 shtator 2024;

e) Dita Botërore e Gjuhës Rome, UNESCO, 5 nëntor 2024;

ë) Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve, 20 nëntor 2024;

f) Dita e Luftës Kundër Bullizmit, 21 nëntor 2024;

g) Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, 22 nëntor 2024;

gj) Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, 3 dhjetor 2024;

h) Dita e të Drejtave të Njeriut, UNESCO, 10 dhjetor 2024;



i) Dita Ndërkombëtare e Emigrantëve, UNESCO, 18 dhjetor 2024;

j) Dita Ndërkombëtare e Edukimit, UNESCO, 24 janar 2025;

k) Përkujtimi i Holokaustit dhe i krimeve kundër njerëzimit, 27 janar 2025;

l) Dita Botërore e Gjuhës Amtare, 21 shkurt 2025;

ll) Dita Ndërkombëtare e Matematikës, UNESCO, 14 mars 2025;

m) Dita Botërore e Poezisë, UNESCO, 21 mars 2025;

n) Dita Botërore e Ujit, UNESCO, 22 mars 2025;

nj) Dita Ndërkombëtare kushtuar Sportit për Zhvillim e Paqe, 6 prill 2025;

o) Dita Ndërkombëtare e Romëve, 8 prill 2025;

p) Dita Botërore e Librit, 23 prill 2025;

q) Dita Ndërkombëtare *e-twinning*, 7 maj 2025;

r) Dita Ndërkombëtare e Bashkëjetesës në Paqe, UNESCO, 16 maj 2025;

rr) Dita Botërore për Diversitet Kulturor, Dialog dhe Zhvillim, UNESCO, 21 maj 2025;

s) Dita Botërore e Mjedisit, UNESCO, 5 qershor 2025;

sh) Dita kundër Shfrytëzimit të Punës së Fëmijëve, 12 qershor 2025;

t) Dita Evropiane e Kujtesës për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare, 23 gusht 2025;

th) Dita Ndërkombëtare e Rinisë, UNESCO, 12 gusht 2025;

u) Kalendari i Ditëve të Evropës dhe veprimtaritë gjithëvjetoare për njohjen e institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës;

v) Konkursët në nivel institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, me tematikë “Të njohim Evropën”;

y) Java Evropiane e Lëvizjes “Now we move”.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

Institucionet që ngarkohen për marrjen e masave dhe zbatimin e këtij udhëzimi

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore parauniversitare.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrin masat e duhura që ky udhëzim të shpërndahet në çdo institucion arsimor parauniversitar dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i sistemit arsimor parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I
ARSIMIT DHE
SPORTIT
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I EKONOMISË
KULTURËS DHE
INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

SHTOJCË

PLANI MËSIMOR I ARSIMIT BAZË PËR KLASAT V–IX

FUSHA/LËNDËT	KLASAT				
	V	VI	VII	VIII	IX
KURRIKULA BËRTHAMË					
GJUHET DHE KOMUNIKIMI	8	8	8	8	8
Gjuhë shqipe	5	5	5	5	5
Gjuhë e huaj e parë	3	3	3	3	3
MATEMATIKË	4	4	4	4	4
SHKENCAT E NATYRËS	2	2	4	6	6
Dituri natyre	2				
Fizikë		1	2	2	2
Kimi				2	2
Biologji		1	2	2	2



SHOQËRIA DHE MJEDISI	2	3	5	5	5
Edukim për shoqërinë					
Qytetari	1	1	1	1	1
Histori	1	1	2	2	2
Gjeografi		1	2	2	2
ARTE	2.5	3	2	2	2
Muzikë	1	1	1	1	1
Art pamor	1	1	1	1	1
Kërcim					
Teatër	0.5	1			
EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	3	3	3	3	3
TEKNOLOGJI DHE TIK	2	2	1	1	1
TIK	1	1	1	1	1
Aftësimi teknologjik praktik	1	1			
KURRIKULA ME ZGJEDHJE	2	2	2	2	2
Totali (orë javore)	25.5	27	29	31	31

URDHËR

Nr. 124, datë 26.7.2024

**PËR CAKTIMIN E NËNPREFEKTIT TË
SARANDËS, Z. KRISTO KIÇO, PËR
USHTRIMIN E KOMPETENCAVE DHE
DETYRAVE TË PREFEKTIT TË
QARKUT VLORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 1/1, të nenit 22, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Caktimin e nënprefektit të Sarandës, z. Kristo Kiço, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të prefektit të qarkut Vlorë.

2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1, të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e prefektit të qarkut Vlorë ose deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet nënprefekti i Sarandës, z. Kristo Kiço dhe institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BRENDSSHËM
Taulant Balla**

URDHËR

Nr. 402, datë 31.7.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 1.8.2024–11.8.2024, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Tedi Dobi

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 12.8.2024–25.8.2024 zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta

3. Ngarkohen zëvendësministrat e Drejtësisë, z. Tedi Dobi dhe z. Klajd Karameta, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja**



URDHËR

Nr. 580, datë 29.7.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BRAZILIT**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;

d) materialit biologjik të shpendëve të pa shoqëruar me test diagnostik PCR, që vërteton mosprezencën e virusit;

e) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, ku përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2.5 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2.3 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës të tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- 65°C në 39.8 sekonda;
- 70°C në 3.6 sekonda;
- 74°C në 0.5 sekonda;
- 80°C në 0.03 sekonda;

f) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Brazilit sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Rio Grande de Sol	Anta Gorda	Anta Gorda*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të

vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Brazilit, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 169, datë 31.7.2024

**PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të lejes vjetore të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Alba Qirjazi, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën nga data 5.8.2024 deri në datën 23.8.2024.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Alba Qirjazi.

4. Znj. Alba Qirjazi nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOLEGJIT TË POSAÇËM
TË APELIMIT
Sokol Çomo

URDHËR

Nr. 150, datë 2.8.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Negocimit dhe Asistencës Ligjore, znj. Denada Dosti.

2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën nga data 6.8.2024 deri më datë 26.8.2024.

3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Dosti, drejtor i Drejtorisë së Negocimit dhe Asistencës Ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 549 (2983), datë 25.6.2024, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Ndrekë Simoni, i datëlindjes 12.4.1973, lindur në Shkodër dhe banues në Rragam, Njësia Administrative Gur i Zi, Bashkia Shkodër, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kuruesit Jakin Simoni.



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 224 lekë